



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Janar 2021/ Nr. 1



Olta Xhaçka, mesazh urimi për FA
Forcat e Armatosura janë
kthyer në një mesazh
shprese dhe besimi



QKMBMMFA/ Festat e fundvitit
Koncerte festive nga
fëmijët artistë për
fëmijët e ushtarakëve



Investimi në Bazën e Kuçovës
Agjencia e NATO-s për Mbështetje
e Prokurime: Interes nga
36 kompani të huaja e vendase



MODERNIZIMI I FORCAVE DETARE
Lockheed Martin do përmirësojë kontrollin
dhe monitorimin e hapësirës detare

Përmbajtja

Numri 1

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ

- 5** FARSH kontribuon për paqen, pjesë në misionet NATO, BE dhe OKB

INVESTIMI NË BAZËN E KUÇOVËS

- 15** Agjencia e NATO-s për Mbështetje e Prokurime: Interes nga 36 kompani të huaja e vendase

NËN PRESIDENCËN E BOSNJË-HERCEGOVINËS

- 13** Karta SHBA-Adriatik (A5) një instrument për forcimin rajonal

ANALIZË

- 46** Dezinformimi në Ballkanin Perëndimor dhe siguria rajonale

RETROSPEKTIVË

- 36** Tanket në stërvitjen "Tomori '68"

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



4 OLTA XHAÇKA, MESAZH URIMI

Forcat e Armatosura janë kthyer në një mesazh shprese dhe besimi

Dua t'i falenderoj nga zemra këta djem dhe vajza që i shërbejnë Shqipërisë brenda dhe jashtë kufijve të saj, për gjithçka kanë bërë në 2020 dhe dua t'u uroj më të mirën për 2021...



9 MODERNIZIMI I FORCAVE DETARE

Lockheed Martin do përmirësojë kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare

Me rastin 95-Vjetorit të Krijimit të Forcës Detare në molin nr. 4 të Portit të Durrësit u kremtua më 24 dhjetor 2020, ceremonia e rastit. Në këtë ceremoni...



7 QKMBMMFA

Koncerte festive nga fëmijët artistë për fëmijët e ushtarakëve

Me rastin e festave të fundvitit, grupet e fëmijeve të ushtarakëve të cilët ndjekin kurset e muzikës: këngës, instrumentave muzikore, si kitarë, piano...



28 53-VJETORI I BAZËS AJRORE-FARKË

Baza Ajrore Farkë, pjesa e nderuar e Forcave Ajrore Shqiptare

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj uron efektivin e Bazës Ajrore Farkë me rastin e 53-Vjetorit të Krijimit të saj...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 1/2021

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfuturi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Ministrja Xhaçka mesazh urimi për FA

Forcat e Armatosura janë kthyer në një mesazh shprese dhe besimi

Dua t'i falenderoj nga zemra këta djem dhe vajza që i shërbejnë Shqipërisë brenda dhe jashtë kufijve të saj, për gjithçka kanë bërë në 2020 dhe dua t'u uroj më të mirën për 2021


Tërmeti dhe më pas pandemia treguan edhe njëherë jo vetëm kapacitetet e Forcave të Armatosura për të përmbushur detyrën e tyre, por njëherësh edhe dimensionin e tyre human duke qenë kudo ku ka nevojë. Përmes një videomesazhi për festat e fundvitit, më 31 dhjetor 2020, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka u shpreh mirënjohjen mijëra burrave dhe grave që mbajnë veshur me krenari uniformën.

Xhaçka thekson se efektivet e FA ia kanë dalë të bëjnë punë shumë të mira, në një vit me shumë sfida. "2020 ishte për FA një vit sfidash, të cilat bashkërisht i kemi kaluar me sukses. Ia kemi dalë të realizojmë shumë punë të mira, për ta bërë FA më moderne, më profesioniste, më pranë standardeve të një ushtrie të NATO, më të aftë për të garantuar sigurinë, jetën shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve shqiptarë.

S'ka qenë e lehtë deri më sot e s'ka për të qenë e lehtë prej këtej e tutje. Por nuk na trembin vështirësitë apo sfidat. Na mjafton që qytetarët sot e vlerësojnë

FA si kurrë më parë. Këta djem dhe vajza që i shërbejnë Shqipërisë brenda dhe jashtë kufijve të saj, dua t'i falenderoj nga zemra për gjithçka kanë bërë në 2020 dhe dua t'u uroj më të mirën për 2021, sepse me punën e tyre janë kthyer në një mesazh shprese dhe besimi, në një mesazh optimizmi për të gjithë. Faleminderit për shërbimin dhe qoftë 2021 një vit më i mbarë për gjithsecilin nga ju dhe familjet tuaja!", shprehet në mesazhin e saj për të gjithë efektivet e FA ministrja Olta Xhaçka.

Forcat e Armatosura sot janë në shërbim 24 orë në 7 ditë të javës dhe falë vendimeve të kësaj qeverie ka një trajtim më të mirë financiar dhe është e pajisur me mjete njësoj si kolegët e tyre të vendeve të NATO-s. Po ashtu investimet në infrastrukturë në këto vite dhe prania në misionet në shumë vende të botës e bëjnë FA eksportues të sigurisë. Një arritje tjetër, është edhe kthimi i Akademisë së Forcave të Armatosura në institucionin e vetëm të arsimit të lartë, i akredituar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



FARSH kontribuon për paqen, pjesë në misionet NATO, BE dhe OKB

Të dashur ushtarë, nënofficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura! Viti 2020 do të mbetet gjatë në kujtesën e çdo personi si në Shqipëri dhe anekënd botës, për shkak të pandemisë të shkaktuar nga COVID-19. Lajme pozitive nga fusha e shkencës, tashmë kanë sjellë shpresë për trajtimin e kësaj sëmundje, gjë e cila kërkon prej nesh durim të shtuar, për të vazhduar kujdesin dhe respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Në retrospektivë, ky fundvit na jep mundësinë për të vlerësuar punën e bërë dhe sukseset e arritura, konsideruar vështirësitë dhe problematikat, që kemi hasur për të vënë në praktikë mësimet e nxjerra, si dhe për të planifikuar e përcaktuar objektivat dhe detyrimet për vitin e ri 2021. Viti që po lëmë pas ishte një vit i pazakontë dhe tejet i vështirë për të gjithë, megjithatë Forcat e Armatosura përmbushën me sukses misionin dhe detyrat kushtetuese. Forcat e Armatosura, në gjithë veprimtarinë e tyre në mbështetje të institucioneve shtetërore për përballimin e pandemisë, në ndihmë të komunitetit dhe popullsisë së prekur nga fatkeqësitë natyrore e shëndetësore, si dhe në operacionet dhe misionet e NATO-s, dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim të lartë. Ushtarakët shqiptarë kanë qenë ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në shtabet, operacionet dhe misionet ndërkombëtare. Gjatë kontakteve me Komandantët e Strukturave të NATO-s, më është shprehur vazhdimisht vlerësimi për performancën e lartë të tyre. Angazhimi dhe kontributi i Forcave të Armatosura nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara, si dhe ato në kuadër të iniciativave rajonale e koalicioneve ndërkombëtare, e kanë rritur rolin e Shqipërisë si faktor kontribues për paqen dhe sigurinë rajonale e globale. Ju faleminderit për angazhimin, kontributin

Ushtarakët tanë do tregojnë vlerat më të mira kudo që të jenë: Afganistan, Kosovë, Sudan i Jugut, Letoni, Bosnjë-Hercegovinë, Mali, shtabe ndërkombëtare apo rajonet stërvitore

dhe sakrificat tuaja dhe të familjeve tuaja në shërbim të vendit, popullit shqiptar dhe Aleancës. Ne jemi krenar me ju!

Unë jam shpresëplotë që viti 2021 do të jetë një vit suksesi për Forcat e Armatosura me projekte ambicioze për modernizimin, rritjen e operacionalitetit dhe ndërveprueshmërisë nëpërmjet vijimit të pjesëmarrjes në operacionet dhe stërvitjet e përbashkëta. Gjithash-

tu, vëmendja do të jetë në rritjen profesionale, edukimin dhe trajnimin e personelit ushtarak, si dhe motivimin e kujdesin për ushtarakët dhe familjarët e tyre.

Forca Tokësore do të jetë e pajisur me sisteme luftarake moderne dhe një grup batalion të ndërveprueshëm me forcat e Aleancës, i cili së bashku me njësi të tjera të FA-së do të jetë pjesë e stërvitjes më të madhe të realizuar ndonjëherë në



territorin e Republikës së Shqipërisë "Defender 21". Forca jonë Ajrore do të ketë në përdorim helikopterët e avancuar amerikanë "Black Hawk", sistemin e vëzhgimit ajror dhe një bazë ajrore, sipas standardeve të NATO-s. Kapacitetet e Forcës Detare do të vijojnë të përmirësohen për të garantuar sovranitetin dhe ligjshmërinë në det si dhe do të sigurojnë mbulimin e hapësirës detare dhe shkëmbimin e situatës me Aleancën.

Akademia e Forcave të Armatosura, me programe tërësisht të transformuara dhe përshtatura, sipas kërkesave të ligjit të Arsimit të Lartë, do të edukojë drejtuesit e ardhshëm të FA-së. FARSH do të vijojë të kontribuojë për paqen në kuadër të misioneve të NATO-s, BE-s dhe OKB-së. Usharakët tanë do të vijojnë të tregojnë vlerat më të mira duke mbajtur lart flamurin kuq e zi, kudo që të jenë në fushëbetejë (Afganistan, Kosovë, Sudan i Jugut, Letoni, Mali, Bosnjë-Hercegovinë), shtabe ndërkombëtare apo rajonet stërvitore.

Së fundmi, me rastin e festave të fundvitit shpreh urimet më të mira për gjithë personelin e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre. Një urim të veçantë e përcjell për të gjitha vajzat dhe djemtë, burrat dhe gratë me uniformë, që në prag të ndërrimit të viteve, ndodhen në krye të detyrës, brenda dhe jashtë vendit, të gatshëm për të përballuar sfidat e paqes dhe sigurisë.

GËZUAR KRISHTLINDJET DHE VITIN E RI! SHËNDET DHE SUKSESE NË 2021! 25 Dhjetor 2020

Urime për 200 efektivë të inkuadruar të misionet NATO, BE dhe OKB

FA përfaqësohet me misione paqeruajtëse në Kosovë, Afganistan, Letoni, Sudanin e Jugut, Mali dhe Bosnje-Hercegovinë

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka zhvilluar një bisedë online me përfaqësues më të lartë në NATO dhe misionet paqeruajtëse në Kosovë, Afganistan, Letoni, Sudanin e Jugut, Mali dhe Bosnje-Hercegovinë. Veç urimit për festat e fundvitit, ministrja e Mbrojtjes është interesuar edhe për shëndetin e efektivëve dhe familjarëve të tyre, në këto kohë të vështira pandemie. "Tek unë do të keni gjithmonë, përveçse një mike shumë të mirë edhe avokaten tuaj më të fortë", u shpreh gjatë bisedës ministrja Xhaçka, ndërsa shprehu mirënjohjen për kontributin e dhënë nga çdo efektiv i FA, brenda dhe jashtë vendit. Në takim online, ku kanë marrë pjesë drejtues të forcave, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, ka siguruar vijimin e vëmendjes për efektivët dhe familjarët e tyre. Aktualisht FA përfaqësohet me 200 efektivë në kuadër të misioneve të NATO-s dhe BE-së në disa vende të botës.

"Tek unë do të keni gjithmonë, përveçse një mike shumë të mirë edhe avokaten tuaj më të fortë", u shpreh gjatë bisedës ministrja Xhaçka, ndërsa shprehu mirënjohjen për kontributin e dhënë nga çdo efektiv i FA, brenda dhe jashtë vendit.





Aktivitetet u organizuan nga QKMBMMFA me rastin e festave të fundvitit Koncerte festive nga fëmijët artistë për fëmijët e ushtarakëve

Intervistë
me regjisorin
Saimir
Braho,
specialist në
Sektorin e
Aktiviteteve
pranë
QKMBMMFA



Me rastin e festave të fundvitit, grupet e fëmijeve të ushtarakëve të cilët ndjekin kurset e muzikës: këngës, instrumentave muzikore, si kitarë, piano, apo pikturë, por edhe sporteve, etj. pranë Sektorit të Aktiviteteve me drejtues sektori, z. Gazment Çaçi, në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, përgatitën dy programe muzikore për moshatarët e tyre, fëmijët e ushtarakëve.

Programi i parë artistik për fëmijët e ushtarakëve ishte një "Musical", ku përmes vargjeve, tingujve dhe kërcimit, fëmijët kanë sjellë një atmosferë të gëzueshme. Koncerti u organizua pranë Muzeut të Forcave të Armatosura ku ishin të pranishëm shumë fëmijë të ushtarakëve, prindër, etj.

Kurse programi i dytë artistik u organizua me fëmijët e ushtarakëve në Komandën Mbeshtetëse. Në këto aktivitete ishin të pranishëm fëmijë, prindër, por edhe zv. Ministri i Mbrojtjes.

z. Petro Koci, Drejtoresha e Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, znj. Mirela Roshi, etj.

Fëmijët sollën një atmosferë të ngrohtë, plot buzëqeshje në këto ditë të ftohta dimri dhe të vështira prej Covid-19 me shpresën se një vit më i mirë na pret përpara.

Të dy programet artistike si ai "Musical" ashtu dhe koncerti i fëmijeve u përgatitën nga specialistët e sektorit të aktiviteteve: regjisorin Saimir Braho, artistët e mirënjohur Kozma Dushi i cili përgatit kurset në kanto, Redon Makashi i cili përgatit kurset në kitarë, Denis Biraku i cili përgatit kurset në piano, por dhe Albina Ceka e cila përgatit kurset në pikturë.

Për më shumë detaje realizuam një intervistë me regjisorin Saimir Braho.

Sektorin e Aktiviteteve, pranë QKMBMMFA, organizoi në ambientet e Muzeut të Forcave të Armatosura,



aktivitetin "Musical" me fëmijët e ushtarakëve, me rastin e festave të fundvitit, si ishte për ju të drejtonit aktivitetin?

Saimir Braho: Aktiviteti i kësaj here ishte i një forme tjetër i përkiste zhanrit artistik teatralo muzikor, ose ndryshe "musical", ku janë të ndërthurura tri element kërcimi, këndimi dhe aktrimi. Fëmijët e qendrës së kulturës me këngën kishin pasur dhe me parë përvojë, kurse me aktrimin dhe kërcimin jo aq shumë. Na u desh të punonim në një kohë të shkurtër, por me fëmijët është gjithmonë avantazh, pasi ata thithin shumë shpejt janë si sfungjer dhe janë të gatshëm për bashkëpunim.

Si ishte të bashkëpunonit me fëmijë, po prindërit e tyre sa ju ndihmuan?

Saimir Braho: Unë kam vite që punoj me fëmijët, nëpër aktivitete artistike, në Akademinë e Arteve, në Teatër dhe në mënyrë private. Te punosh me fëmijët është një kënaqësi e veçantë dhe kënaqësia shumëfishohet kur sheh prindër të gëzuar, ata janë treguar të gatshëm të sillnin dhe të merrnin fëmijët e tyre përditë. Por gjeja më e rëndësishme është kur kjo të kthehet me mirënjohje.

A ka ndryshim mes aktivitetit të organizuar me fëmijët artistë të vegjël që ndjekin kurset pranë Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, dhe aktiviteteve të tjera artistike që keni zhvilluar, apo marrë pjesë?

Po ka ndryshim, është fakti që fëmijët që ndjekin kurset këtu ishin të përgatitur nga ana artistike, në pjesën e këndimit kishin një lloj përvojë.

Covid-19 ka vështirësuar jetën e gjithsecilit prej nesh, sa e vështirë ishte për ju të punonit për të realizuar aktivitetin me fëmijët e ushtarakëve?

Saimir Braho: Në këtë situatë një nga gjerat që e ka të vështirë të realizohet është arti, ose më



saktë arti kolektiv, pasi njerëzit duhet të qëndrojnë bashkë, prandaj arti është shumë i penalizuar në këtë kohë. Mirëpo po të shohësh anën tjetër të medaljes njerëzit janë të etur për art si për ata që prodhojnë edhe për ata që e shijojnë. Njerëzit e marrin me

shumë gëzim për ti parë shfaqjet në këtë situatë, pasi janë më të gatshëm për të shijuar, gjithmonë duke iu përmbajtur rregullave të distancimit social. Kurse fëmijët nga natyra e tyre nuk mund ti kuptojnë plotësisht vështirësitë që sjell kjo situatë.

A ju kanë ndihmuar eksperiencat tuaja artistike në realizimin e këtij "musical"?

Saimir Braho: Po sigurisht që po, nëse dikush nuk e ka këtë përvojë has probleme që në fillim, kurse kur ke përvojën ke parasysh rrugën që do të ndjekësh. Dhe komunikimi me njerëzit është sërish për shkak të përvojës, pasi kështu është më e lehtë të prodhosh atë që do. Urat e komunikimit janë të krijuara më përpara, kështu ti e di se çfarë kërkon.

Po institucioni ku ju punoni QKMBMFA çfarë përfaqëson për ju?

Saimir Braho: Përfaqëson një mundësi për ta provuar, për ta ushtruar këtë pasion, që kam në mënyrë të tillë që të kem pikat e kontaktit në një zonë, në një ambient i cili është goxha i gjerë: bëhet fjalë për Forcat e Armatosura të cilat janë shumë dhe janë kudo, kështu në momentin që ti shërben në këtë institucion ke mundësi ta shprehësh atë, siç ishte dhe rasti i aktivitetit që realizuam. Nga ana tjetër është një sfidë që jam në këtë institucion, pasi kam mundësinë për të bërë disa aktivitete, që nuk janë bërë më parë.

Cili është urimi juaj për ushtarakët tanë dhe gjithë shqiptarët?

Saimir Braho: Viti që do të vij shpresojmë të gjithë se nuk do të ketë probleme të tilla siç patëm në vitin që lamë pas, por dimë se do të ketë gjithmonë problem. Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes, ashtu siç kanë pasur çdo vit, do kenë gjithmonë sfida në aspektin e emergjencave civile. Unë uroj që ata këtë vit ta marrin me krah të lehta për të bërë atë që ata bëjnë çdo vit, të kenë zemër të fort dhe mendje të kthjellët, shëndet dhe mbarësi në familjet e tyre dhe mbi të gjitha paqe.

Përgatiti: Hajrie Dedaj

Lockheed Martin do përmirësojë kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare

Me rastin 95-Vjetorit të Krijimit të Forcës Detare në molin nr. 4 të Portit të Durrësit u kremtua më 24 dhjetor 2020, ceremonia e rastit. Në këtë ceremoni të rëndësishme morën pjesë ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj, Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të FA, përfaqësues të institucioneve detare, të administratës detare, Portit Durrës, QNOD, veteranë të Flotës dhe personel detar i Forcës Detare.

Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia i uroi detarëve 95 - Vjetorin duke theksuar se "... është privilegj dhe kënaqësi e veçantë t'ju drejtohem sot me rastin e 95 - Vjetorit të Krijimit të Forcës Detare. Traditat detare të popullit tonë janë po aq të lashta sa dhe vetë historia e tij. Efektivat që ndodhen sot para jush dhe detarët tanë janë pasardhës të denjë të traditës detare, që vjen e gjallë prej lashtësisë. Historia moderne e Forcës Detare shqiptare daton më 25 Dhjetor 1925, kur një grup marinarësh nën drejtimin e Ahmet Kapidanit valëvitën flamurin shqiptar në ujërat tona territoriale. Anijet "Shqiponja" dhe "Skënderbeg" dhanë sinjalin e parë të patrullimit të Forcës Detare, në emër të ruajtjes së kufirit të shtetit shqiptar.

Në përfundim më lejoni që



Xhaçka: Pas pajisjes së anijeve të klasit Iliria me topa 20mm, do të vijojmë me disa projekte të tjera modernizuese, siç janë pajisja e anijeve me sisteme komunikimi, që do të na lehtësojnë komunikimin me aleatët.

në këtë 95-Vjetor të krijimit të Forcës Detare të falënderoj të gjithë ata detarë nënoficerë dhe oficerë, që ndër vite me sakrificën,

guximin dhe heroizmin e tyre duke u përballur me sfidat e detit, gjatë lundrimeve në mot të qetë e të trazuar, ditën dhe natën i dhanë





jetë Forcës Detare duke e sjellë deri në ditët e sotme. Ata do të jenë gjithmonë burim frymëzimi dhe force për ne. Nga ana tjetër ne kemi përgjegjësinë, që ta çojmë përpara dhe ta zhvillojmë Forcën Detare që trashëguam, me qëllim që të kryejmë me sukses detyrat e shenjta, që na janë ngarkuar.” Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, në këtë përvjetor kujtoi një nga performancat më të jashtëzakonshme të FD në Detin Egje, gjatë operacionit “Sea Guardian”, duke shpëtuar mbi tremijë jetë njerëzish.

Duke vlerësuar mbështetjen e partnerëve e aleatëve të NATO-s, ministria e Mbrojtjes tha: “Projekt i më i rëndësishëm është kontrata afatgjatë e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare me kompaninë amerikane Lockheed Martin, që do të përmirësojë kontrollin dhe monitorimin e hapësirës detare”.

“Pas pajisjes së të gjitha anijeve të klasit Iliria me topa 20mm, vitin që vjen, siç diskutuam edhe me gjeneral Xhebexhinë, do të vijojmë me disa projekte të tjera modernizuese, siç janë pajisja e anijeve me sisteme dhe pajisje komunikimi, që do të na lehtësojnë komunikimin me aleatët”, - thek-

soi ministria Xhaçka, teksa foli edhe për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së riparimit të anijeve të Forcës Detare duke i hapur rrugë

projekteve të modernizimit me anije të reja dhe moderne. Forca Detare mban si ditë të formimit të saj 25 Dhjetorin e vitit 1925.

Ja misioni i Forcave Detare

Forca Detare ka për mision sigurimin dhe ruajtjen e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimin e ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëveprim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare. Të sigurojë në çdo kohë, aftësi operationale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t’ju përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues. Të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operatione të përbashkëta me strukturat e FA-së dhe të NATO-s në drejtimet e kërcënuara. Monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë. Organizimi dhe realizimi i operationeve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe operationeve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA. Të ruajë dhe të mbrojë mjedisin detar për zbatimin e ligjshmërisë në det. Sigurimi i kushteve hidrolundimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH. Të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve. Të marrë pjesë në përballimin e rreziqeve asimetrike të terrorizmit, krimit të organizuar në bashkëveprim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.



Nga viti 1925 deri tek misioni “Sea Guardian” në detin Egje

“ Në misionin “Sea Guardian”, shërbyen 14 kontingjente të përbërë nga 294 detarë, në bordin e 3 anije të Forcës Detare, “Oriku”, “Butrinti” dhe “Lissus”.



Me shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor 1912, u bënë përpjekjet e para për organizimin e FD shqiptare nga qeveria e Ismail Qemalit, por fillimi i Luftës së Parë Botërore e ndërpreu këtë angazhim. Në vitin 1925, organizimi i ushtrisë synoi të bëhej mbi bazën e statusit të Shqipërisë hartuar më 7.3.1925. Mbi bazën e këtij statusi u krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive Ushtarake. Më 25 dhjetor 1925, mbërrinë nga Italia dy anije 190 tonësh, të cilat u emërtuan me emrat domethënës “Shqipëria” dhe “Skënderbeu”. Këto anije u pajisën me efektiva marinarësh duke kryer detyra në interes të luftës kundër kontrabandës në brigjet shqiptare.

Më 1928, u krijua Komanda e Marinës dhe më konkretisht më 24.06.1928, kur u mblohdën rekrutët e parë për këtë armë. Më 1934, u blenë po nga Italia edhe dy anije të tjera të lehta, të cilat u emërtuan “Saranda” dhe “Durrësi”. Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore pothuajse u shkatërrua gjithçka nga këto anije. Çlirimi i Shqipërisë e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme me pothuajse të gjitha anijet e mbytura në portet e bregdetit shqiptar. Në prill 1945, u krijua Kantieri Detar-Durrës për riparimin e varkave ekzistuese, nxjerrjen e anijeve të mbytura gjatë luftës dhe përgatitjen e tyre për qëllime ushtarake. Më 15 gusht 1945, u bë përrurimi i hedhjes në ujë të dy motoskafeve trofe, me numër MS-10 dhe MS-12. Këto motoskafe u armatosën me mitraloz të lehtë dhe filluan patrullimin për ruajtjen e ujërave bregdetare në Vlorë e Sarandë. Në këtë periudhë u punua me një vizion të qartë për zhvillimin dhe perspektivën e Forcave Detare, duke shfrytëzuar edhe konjunkturën politike të kohës. Kështu mund të përmendim vitet '53-'54, që shënuan fillimin e një etape të re zhvillimi të FD me pajisjen e tyre me silurhedhëse e më vonë me minaheqëse, gjuajtës detar dhe anije ndihmuese të llojeve të ndryshme. Më 14 shkurt 1954, u krijua Skuadrilja e Katrave Silurues me vendbazim në ishullin e Sazanit, kjo shënon edhe fillimin e një stadi të ri zhvillimi të FD. Zhvillimi e modernizimi i flotës filloi me ritme të shpejta, sidomos pas vitit 1957. Më 21 shtator 1958, filloi aktivitetin një nga njësitë më speciale e më të rëndësishme të FD shqiptare, Njësia

e Nëndetëseve, në përbërje të së cilës ishin 4 nëndetëse të prodhuara në ish-Bashkimin Sovjetik. Në gusht të vitit 1962, u hap Shkolla e Marinës në Vlorë e cila pas viteve 1990 është mbyllur. Mbas viteve '90, për FD shtrohej detyra e ristrukturimit, rikonceptimit të reparteve të saj për një integrim të natyrshëm me strukturat e NATO-s. U zhvilluan me sukses mjaft stërvitje të përbashkëta, si “SAREX-1”, “SAREX-2”, “MAREX-1”, “MAREX-2”, etj., Vlen për t'u përmendur në këtë proces ringritje, ndihma e partnerëve tanë perëndimorë si: SHBA, Italia, Turqia, Greqia, Gjermania, etj.. Në mars të vitit 1998, me ndihmën e qeverisë së SHBA-së, FD u pajisën me 5 morovedeta, të cilat u bënë protagoniste të operacioneve SAR në vitet e ardhshme. Më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit të FD, 4 nëndetëse të saj, pas një vepërimitarie 40-vjeçare. Në vitin 2002, me kontributin e qeverisë italiane pas miratimit të ligjit të Rojës Bregde-

tare shqiptare, nr. 8875 datë 4 prill 2002. FD u pajisën dhe me 6 motovedeta nga Italia, të cilat së bashku me anijet amerikane u futën në strukturat e Rojës Bregdetare. Mbas një pune njëvjeçare, në muajin nëntor 2008, u zhvilluan provat finale për marrjen në dorëzim të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit Detar (SIVHD), të instaluar nga specialistët e kompanisë “Lockheed Martin”. Pas 3 vitesh dhe rreth 13 mijë orëve patrullim në detin Egje, Forca Detare ka përfunduar në dhjetor 2019, kontributin e saj në misionin e NATO-s, “Sea Guardian” në detin Egje. Gjatë 3 viteve në këtë mision, ekuipazhet dhe anijet shqiptare kanë realizuar 178 operacione, duke shpëtuar ose parandaluar rreth 3500 persona, mes të cilëve 120 gra, 220 fëmijë, 38 prej të cilave foshnja. Në misionin “Sea Guardian”, shërbyen 14 kontingjente të përbërë nga 294 detarë, në bordin e 3 anije të Forcës Detare, “Oriku”, “Butrinti” dhe “Lissus”.



XHAÇKA NË TAKIMIN E FUNDVITIT ME ATASHETË USHTARAKË TË HUAJ

Të angazhuar në bashkëpunimin dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar

Atashetë ushtarake dhe vendet të cilët ato përfaqësojnë për bashkëpunimin e deritanishëm me Ministrinë tonë të Mbrojtjes, duke vënë theksin në mbështetjen e vazhdueshme që këto vende të NATO-s ofrojnë për vendin tonë. Bazuar në kalendarin e aktiviteteve të dedikuara për atashetë ushtarake të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, u zhvillua më datë 9 dhjetor 2020, takimi i fundvitit. Marrë në konsideratë situatën e pandemisë takimi u zhvillua në platformë online. Fokusi kryesor i takimit ishte një prezantim i përgjithshëm mbi Forcat e Armatosura të RSH, roli dhe misioni i tyre, pjesëmarrja e tyre në misionet jashtë vendit si dhe bashkëpunimi dypalësh, rajonal dhe ai ndërkombëtar.

Në takim morën pjesë atashetë ushtarake të NATO të akredituar në vendin tonë (dhe ata jo-rezident) si dhe atasheu ushtarak i Kosovës.

Takimi u çel me një fjalë përshëndetëse të ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, e cila gjatë fjalës



Në takim morën pjesë atashetë ushtarake të NATO të akredituar në vendin tonë (dhe ata jo-rezident) si dhe atasheu ushtarak i Kosovës

së saj falënderoi atashetë ushtarake dhe vendet të cilët ato përfaqësojnë për bashkëpunimin e deritanishëm me Ministrinë tonë të Mbrojtjes, duke vënë theksin në mbështetjen e vazhdueshme që këto vende të NATO-s ofrojnë për vendin tonë. Në mënyrë të veçantë, znj. Xhaçka shprehu mirënjohjen për respiratorët e ofruar nga NATO, duke e konsideruar si ndihmë të vyer për përballimin e situatës në të cilën po kalojmë. Zonja Xhaçka konfirmoi që Ministria e Mbrojtjes do të vijojë kontributin e saj si një aleat i denjë i NATO-së, si dhe vijojë angazhimin e saj në forcimin e bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe atë ndërkombëtar. Takimi vijoi më pas me fjalën përshëndetëse të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bajram Begaj, i cili ndër të tjera nënvizoi se Forcat e Armatosura të RSH-së do të vijojnë të përmbushin detyrimet si vend anëtar i NATO-s dhe do të

vazhdojnë kontributin e tyre për sigurimin e paqes dhe rendit në rajon dhe më gjërë.

Pas prezantimit mbi aktivitetet kryesore të ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm gjatë vitit 2020, rolin dhe kontributin e tyre gjatë periudhës së pandemisë, atashetë ushtarake të huaj u njohën me angazhimet për vitin 2021.

Sesioni u fundit i takimit ishte i dedikuar për pyetje të cilat u adresuan nga atashetë ushtarake dhe morën përgjigje nga përfaqësuesit e strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Në fund të takimit atashetë ushtarake shprehën falënderimet e tyre për punën e bërë deri më tani nga Ministria e Mbrojtjes, si dhe në dedikimin e saj në realizmin e detyrave dhe aktiviteteve pavarësisht situatës së përkeqësuar të COVID-19.

Nën drejtimin e Bosnjë-Hercegovinës, u zhvillua online më 30 nëntor 2020, takimi i ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare dhe vëzhguese të Karta e Adriatikut SHBA-A5, ku vendi ynë u përfaqësua nga zv/ministri i Mbrojtjes, z.Petro Koci. Përmes një video konference, u diskutua mbi temat me interes më të lartë-trajtimi i pandemisë së korona virusit, sfidat dhe mundësitë pas pandemisë, fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal, keqinformimi, që është gjithashtu një rrezik i sigurisë, si dhe menaxhimi i krizës dhe rëndësia e integritetit Euro-Atlantik. Në takim morën pjesë ministrat e Mbrojtjes të Bosnjë dhe Hercegovinës-Sifet Podzhiq, Malit të Zi-Predrag Bosković, Maqedonisë së Veriut -Radmila Shekerinska, sekretari shtetëror kroat-Zdravko Jakop, dhe nënsekretari i për Politikë Mbrojtëse të SHBA-së, Antony Tata. Në takim morën pjesë gjithashtu përfaqësues të vendeve vëzhguese, ministri i Mbrojtjes së Kosovës Anton Çuni dhe sekretari shtetëror në Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë-Urosh Lampert.

Takimi u zhvillua në dy sesione plenare me temat të cilat u fokusuan në programet e bashkëpunimit rajonal të mbrojtjes, me theks të veçantë në pandeminë aktuale COVID-19, ndikimit të saj në performancën e aktiviteteve të planifikuara të institucioneve të mbrojtjes, si dhe epoka post-COVID me rreziqet, sfidat dhe mundësitë. Gjithashtu, në sesion të veçantë u shqyrtua rëndësia e partneritetit të NATO-s dhe integritetit euro-atlantik në menaxhimin e krizave dhe përbashkëtimin e sfidave aktuale të sigurisë.

Në fund të takimit, zv/ministri i Mbrojtjes, z.Petro Koci tha se: "Në emër të Republikës së Shqipërisë theksova nevojën e fuqizimit të inisiativës me politikën e dyerve të hapura duke pranuar vende vë-

Zv/ministri Koci merr pjesë në takimin Karta e Adriatikut SHBA-A5



NËN PRESIDENCËN E BOSNJË-HERCEGOVINËS

Karta SHBA-Adriatik (A5) një instrument për forcimin rajonal

zhguese si Kosova me të drejta të plota. Gjithashtu e bëmë të qartë se Serbia vazhdon të bëjë lojën e interesave ruse në rajon. Ajo po ndjek vetëm me fjalë politikën neutrale përse i përket përcaktimeve për sigurinë dhe mbrojtjen, ndërsa me vepra pozicionohet haptazi me Rusinë. Kënaqësi e veçantë ishte pjesëmarrja dhe kontributi i Ministrisë të Mbrojtjes të Kosovës, Anton Çuni. Në deklaratën e përbashkët nga takimi ministror u nënvizua angazhimi i fortë i vendeve

anëtare të Kartës së Adriatikut për të zhvilluar bashkëpunimin rajonal të mbrojtjes dhe për të nxitur mbrojtjen dhe reformat e sigurisë. Mbështetja ushtarake e autoriteteve civile në trajtimin e COVID 19 u përshëndet dhe u theksua rëndësia e koordinimit rajonal në trajtimin e krizave. Bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i përvojave në trajtimin e pandemisë do të përmirësojë gatishmërinë kombëtare dhe kolektive për të trajtuar me sukses sfidën.

Mali i Zi-Shqipëri: Do të forcohet bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes e Malit të Zi,

Olivera Injac u takua me Ambasadorin e

Republikës së Shqipërisë në Malin e Zi, Ridi Kurtezi

Ministrja e Mbrojtjes e Malit të Zi, Olivera Injac u takua më 11 dhjetor 2020 me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Malin e Zi, Ridi Kurtezi. Ministrja Injac shprehu kënaqësinë për takimin, duke pritur që gjatë mandatit të saj, bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë në fushën e mbrojtjes do të përmirësohet më tej, veçanërisht duke pasur parasysh interesat dhe angazhimet tona të përbashkëta, që ne ndajmë si fqinjë dhe aleatë në NATO. Injac e informoi ambasadorin Kurtezi për planet dhe aktivitetet e ardhshme në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ambasadori Ridi Kurtezi përgëzoi ministren Injac për zgjedhjen e saj në detyrë dhe shprehu gatishmërinë e saj për të vazhduar dhe thelluar bashkëpunimin e suksesshëm në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve aleate. Kurtezi gjithashtu iu referua bashkëpunimit thelbësor midis dy vendeve brenda kornizës së iniciativave rajonale, e cila kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në forcimin e besimit. Gjatë takimit, Ambasadori Kurtezi ka përcjellë

urimet më të mira për sukses gjatë mandatit në institucionin, që ajo drejton si dhe ka riafirmuar qëndrimin e Qeverisë shqiptare për të zgjeruar dhe për të intensifikuar më tej marrëdhëniet mes dy vendeve tona fqinjë, në dobi të progresit të gjithanshëm demokratik dhe përshpejtimit të agjendës së integritetit në sistemin e vlerave dhe standardeve evropiane. Ambasadori Kurtezi ka vlerësuar se pakica shqiptare në Malin e Zi është një urë e qëndrueshme miqësie dhe

një faktor i rëndësishëm paqeje, stabiliteti, zhvillimi dhe integriteti. Pasi ka vlerësuar atë çka është realizuar deri më sot, ai ka inkurajuar forcimin e mëtejshëm të kohezionit social, krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e Malit të Zi. Bashkëbiseduesit theksuan besimin e përbashkët se të dy vendet do të bëjnë me sukses progres në zbatimin e agjendës së integritetit evropian, me mbështetjen e ndërsjellë, e cila do të vazhdojë të jetë themeli i stabilitetit në rajon.





INVESTIMI NË BAZËN E KUÇOVËS

Agjencia e NATO-s për Mbështetje e Prokurime: Interes nga 36 kompani të huaja e vendase

Investimi për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës dalën-gadalë po merr formë. Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimet (NATO Support and Procurement Agency, NSPA) zbriti në terren bashkë me kontraktorët potencialë për t'i informuar mbi projektin", - thuhet në 11 dhjetor në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Sipas njoftimit zyrtar, përfaqësuesit e Agjencisë së NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimet prezantuan procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm, që duhet të përmbushin firmat kontraktore, përpara se të aplikojnë për kryerjen e punimeve për modernizimin e Bazës së Kuçovës dhe kthimin e saj në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s.

Në këtë Konferencë morën pjesë përfaqësues të kontraktorëve potencialë nga disa vende të botës dhe grupi i punës i Forcave të Armatosura të Republikës së Shq-



Në takim morën pjesë 60 përfaqësues të kontraktorëve potencialë 36 kompani të ndryshme, nga të cilat 22 të huaja dhe 14 shqiptare

ipërisë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Agjencisë së Prokurimeve dhe Mbështetjes së NATO-s i njohën përfaqësuesit e kontraktorëve potencialë me afatet si dhe inspektuan në terren sheshet e ndërtimit ku do të zbatohen projektet e modernizimit të Bazës Ajrore të Kuçovës.

Për shkak të pjesëmarrjes së madhe dhe masave kundër përhapjes së pandemisë, takimi u zhvillua në dy sesione. Në takim morën pjesë 60 përfaqësues të kontraktorëve potencialë 36 kompani të ndryshme, nga të cilat 22 të huaja dhe 14 shqiptare.

Deri në fund të muajit janar 2021, NSPA do të jetë e gatshme t'i përgjigjet çdo pyetjeje nga kompanitë e interesuara. Pas kësaj, deri në fund

të muajit mars, kompanitë do të paraqesin ofertat, do të vlerësohen ato dhe do të shpallet fituesi. Pas firmosjes së kontratës, parashikohet, që punimet në terren të nisnin në muajin tetor 2021.

Gjithçka mori rrugë, më 21 tetor 2020, kur Komisioni për Sigurinë Kombëtare miratoi marrëveshjen teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s, për realizimin e projekteve të Kuçovës, të financuara nga programi i investimeve të NATO-s për sigurinë, vitet 2019-2022.

NATO do të investojë mbi 50 milionë euro vetëm në fazën e parë të projektit për modernizimin e bazës

ajrore të Kuçovës.

“Baza Ajrore e Kuçovës ka një histori të vjetër, ka filluar të përdoret si fushë aviacioni gjatë Luftës së Dytë Botërore nga ushtria italiane. Pas luftës nuk ka pasur aktivitet, deri në 5 maj të vitit 1955 datë shënon inaugurimin, si baza e parë ajrore e Aviacionit Luftarak Shqiptar. Për 50 vjet ka qenë shkolla praktike e fluturimeve luftarake për të gjithë pilotët, teknikët, specialistët dhe inxhinierët e avionëve aktivë të diplomuar nga shkolla e aviacionit. Janë kryer mijëra orë fluturime ditën dhe natën. Baza e Kuçovës e ka kryer me sukses detyrën, sot në bazë zhvillohen fluturime bashkë me partnerët e NATO-s. Ky vendim i Aleancës për ta kthyer në bazë taktike, do na shërbejë për të rritur shkallën e ndërveprueshmërisë me Aleancën”, - tha më 12 nëntor 2018, ish-komandanti i Forcave Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj.

Gjatë konferencës për shtyp, në Ministrinë e Mbrojtjes në prani të ministres Olta Xhaçka, në Tiranë, më 24 janar 2019, gjenerali i NATO-s, Tod Wolters ka folur edhe lidhur me arsyen se përse në Ballkan u zgjodh baza ajrore e Kuçovës. “Unë do të flas për Shqipërinë në lidhje me Kuçovën. Kemi një fushë të pozicionuar në një vend shumë strategjik. Ka kushte atmosferike shumë të mira ku edhe mund të ulen shumë lehtësisht avionët. Do të vazhdojmë me përmirësimin e infrastrukturës. Forcat e armatosura shqiptare i japin një investim të fuqishëm NATO-s”, - tha gjenerali Tod Wolters.

Kurse ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka deklaroi se: “Baza Ajrore e Kuçovës do të jetë së shpejti një bazë e NATO-s. Shqipëria është një vend i sigurt, ku Aleanca do të investojë kapacitetet e saj. Investimi i NATO-s në Kuçovë është i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë kombëtare, por edhe atë rajonale. Brenda pak muajsh do jetë gati master-plani nga Agjencia e NATO-s për Prokurimet dhe Mbështetjen-NSP. Master-plani i hap rrugë fillimit të punimeve në terren. Demonstrimi që pamë sot tregon qartazi fuqinë e aleancën në shërbim të mbrojtjes kolektive. Vizita e gjeneralit dëshmon

qartë vëmendjen. Shqipëria është angazhuar në një sërë nismash në NATO. Kjo është e vetmja rrugë që tregon se vlerat euroatlantike janë zgjidhja dhe zgjedhja e Ballkanit Perëndimor,” - tha Xhaçka.

Me 5 gusht 2018, gazeta prestigjioze amerikane “Washington Post”, i ka dedikuar një artikull bazës ajrore që pritet të ndërtohet.

“Baza ajrore ka qenë atje për dekada të tëra. Baza do t’i shërbejë Shqipërisë dhe gjithashtu do të mbështesë operacionet e furnizimit me ajër të NATO-s, mbështetjen e logjistikës, policinë ajrore dhe stërvitjet. Kryeministri tha gjithashtu se zyrtarët po diskutojnë me Shtetet

e Bashkuara mbi modernizimin e mëtejshëm të kapaciteteve ajrore shqiptare”, shkruhet në artikullin e “Washington Post”.

Vendimi është marrë nga Këshilli i Atlantikut Verior, organi kryesor ky për vendimmarrjen politike të NATO-s. Lajmi është bërë i ditur nga vetë kryeministri i Shqipërisë, i cili me anë të një postimi në Facebook tha më 4 gusht 2018 se: “Këshilli i Atlantikut të Veriut i NATO-s, organi kryesor vendimmarrës politik, ka vendosur të investojë 50 milionë euro për modernizimin e bazës ajrore në Kuçovë, 80 kilometra (50 milje) në jug të kryeqytetit Tiranë”.

KOLONEL YLLI PULAJ

Bashkëpunimi me Forcat Ajrore Italiane do konsolidohet më tej

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj priti në 17 dhjetor 2020, në një takim zyrtar atasheun ushtarak të Republikës së Italisë në vendin tonë, kolonel Nicola Piccolo. Kolonel Pulaj falenderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Republika e Italisë dhe Forcat e Armatosura Italiane kanë dhënë në rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të Forcës Ajrore. Në vijim, ai njohu atasheun me zhvillimet aktuale në Forcën Ajrore, duke shprehur vullnetin në vijimin e bashkëpunimit ushtarak kryesisht në zhvillimin e kapaciteteve e teknikës ajrore, por edhe në drejtim të kualifikimit të burimeve njerëzore.

Nga ana e tij, kolonel Piccolo, falenderoi kolonel Pulaj për pritjen e ngrohtë dhe theksoi se, bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcën Ajrore do vijojë edhe në të ardhmen duke synuar



rritjen më tej të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, sidomos me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave Ajrore Italiane me qëllim mbështetjen dhe mundësimin e realizimit të aktiviteteve ushtarake dypalëshe duke përfshirë edhe implikimet që sjell situata e pandemisë COVID-19. Në përfundim, kolonel Pulaj shprehu bindjen se, bashkëpunimi ushtarak midis Forcës Ajrore Shqiptare dhe atyre Italiane do të konsolidohet më tej, si në kuadër të bashkëpunimit ushtarak dypalësh ashtu edhe në kuadër të NATO-s, si dhe falenderoi edhe një herë kolonel Piccolo për vizitën duke i uruar punë të mbarë e suksese në detyrën e atasheut ushtarak të Republikës së Italisë në vendin tonë.

Më datë 10 dhjetor 2020, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj priti në një vizitë kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonel Muhammet Kelami Kablay. Gjatë vizitës, kolonel Kablay shoqërohej nga oficeri koordinator i palës turke në Bazën Ajrore, Kuçovë major Taner Arin dhe asistenti i tij.

Kolonel Pulaj falenderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas dhe për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë Republika e Turqisë dhe Forcat e Armatosura Turke në rritjen e zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të Forcës Ajrore si dhe shprehu mirënjohjen e Forcës Ajrore dhe FARSH për mbështetjen me investime nga Forcat e Armatosura Turke të disa projekteve infrastrukturore në Bazën Ajrore, Kuçovë.

Më pas, Kolonel Kablay, falenderoi zëvendëskomandantin e

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj

Turqia kontribuon në rritjen e kapaciteteve të Forcës Ajrore

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj priti atasheun ushtarak të Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay



Forcës Ajrore për pritjen dhe shprehu vlerësimet e tij personale dhe të Forcave të Armatosura të

Turqisë për vijimin e bashkëpunimit në fushat që të dy palët e shohin me interes të përbashkët.

Pak histori nga Baza Ajrore e Kuçovës

Reparti Ushtarak 3362 Kuçovë mbante emrin Reparti "23 Peza". Ai u krijua si formacioni i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik, për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej repartit. Krahas këtyre u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës. Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhiniero-teknik, Regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për kryerjen e detyrave. 15 maj 1955 është dita e krijimit të regjimentit. Me vendim të posaçëm të Kuvendit Popullor Nr.81 datë 6.11.1956, Në korrik të vitit 1957 në këtë aerodrom u ul për herë të parë avioni bombardues JI- 28, i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Në dhjetor në Kuçovë ulet një avion transporti anglez Skymaster. Në muajin shtator 1959 regjimenti mori pjesë në



stërvitjen me trupat e armatës në rajonin e Ersekës.. Në muajin prill të vitit 1961, për herë të parë filloi eksperimentimi i karburantit të markës shqiptare i prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës. Komandanti i Regjimentit piloti Niko Hoxha me avionin 332 bëri provën e parë në ajër. Në vitin 1965 krijohet skuadrilja e tretë reaktivo-mësimore për përgatitjen e pilotëve, teknikëve të rinj. Në fillim të vitit 1966 filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve, ndërsa në muajin prill repartit pajiset me një skuadrilje MIG-17. Në gusht të

vitit 1975 eksperimentohet për herë të parë qitje natën me raketa, ndërsa në vitin 1977 për herë të parë eksperimentohet bombardimi nga fluturimi horizontal në lartësi të vogël. Në vitin 1979, u vu në gatishmëri për drejtimin luftarak të regjimentit Vendkomanda e Kohës së Luftës. Në vitin 1984 repartit emërohet "Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës Bombardues", ndërsa në vitin 1985 dekorohet me urdhrin "Për shërbime të shquara në fushën e mbrojtjes". Në vitin 1995 krijohet Baza e Mbrojtjes Ajrore Kuçovë, Reparti Ushtarak 4030.

Forcat e Armatosura sot vlerësohen nga qytetarët shqiptarë si institucioni më i besueshëm. Në 108 - Vjetorin e Themelimit, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka shpreh krenarinë për ndryshimet dhe arritjet e kësaj force. “Në 108 vjet Forcat e Armatosura kanë pasur një histori plot drama e suksese, dhimbje e gëzim, ulje e ngritje. Një histori që ndërthuret e bëhet njësh me historinë e Shqipërisë e shqiptarëve. Sot unë ndihem krenare që Forcat e Armatosura vlerësohen nga shqiptarët si institucioni më i besueshëm e i respektuar, ashtu si ndihem krenare kur partnerët e aleatët tanë vlerësojnë performancën e djemve e vajzave tona me uniformë dhe përparimin e madh që FA kanë bërë”, -shkruan ministrja Xhaçka, në rrjetin social facebook. Ajo shton se: “ka ende shumë punë për të bërë,

Krenare që shqiptarët e vlerësojnë FA si institucionin më të besueshëm

“Mirënjohje e krenari për ata djem e vajza, që me punën e tyre po e shndërrojnë FA-në realisht në një forcë të standardeve të NATO-s”



por është fakt që FA sot është një forcë më moderne, më profesionale, me ushtarakë që arsimohen e stërviten njësoj si kolegët e tyre të NATO-s, ndërkohë që trajtohen sot financiarisht e janë të pajisur shumë herë më mirë”.

Ministrja e Mbrojtjes shpreh mirënjohjen për këdo, që ka kontribuar për FA-në. “Mirënjohje e krenari për ata djem e vajza që me punën e tyre po e shndërrojnë FA-në realisht në një forcë të standardeve të NATO-s”, - shprehet Xhaçka.

Mesazhi i Presidentit Ilir Meta për 108 vjetorin e FA-së

Qeveria e drejtuar nga Ismail Qemali, më 4 dhjetor 1912, krijoi ushtrinë shqiptare. Me rastin e 108-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Ilir Meta ka përcjellë një mesazh urimi:

“Me rastin e 108-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ju shpreh të gjitha grave dhe burrave në uniformë, konsideratat më të larta, urimet më të përzemërta, falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për kontributet, përkushtimin dhe sakrificat në mbrojtje të Atdheut, Sigurisë Kombëtare, por edhe garantimit të lirisë, paqes e stabilitetit në rajon e botë, nën flamurin e NATO-s! Edhe ky përvjetor, pas tërmetit tragjik të vitit të kaluar, na gjen në një periudhë të pazakontë dhe tepër të vështirë, të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Koha shtron si domosdoshmëri një solidaritet mbarëkom-

Zoti i bekoftë ushtarakët shqiptarë dhe familjet e tyre!

Me sfidat e reja të sigurisë, që parashtron koha, modernizimi i pandalshëm i ushtrisë shqiptare është domosdoshmëri!



bëtar, bashkëpunim dhe gjithë përfshirje, për të mposhtur këtë armik të përbashkët, që kërcënon çdo ditë shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Duke përgëzuar Forcat tona të Armatosura, veçanërisht Njësinë Mjekësore Ushtarake, për vigjilencën, gatishmërinë

e përkushtimin në krye të detyrës, në Spitalin e Traumës dhe në çdo repart e strukturë të FA, ju inkurajoj të vijoni në përmbushje të misionit tuaj kushtetues, për të qenë kurdoherë në shërbim të qytetarëve në nevojë.

Me këtë rast, ju shpreh ngushëllimet e mia të gjithë familjarëve të ushtarakëve, të cilët kanë humbur të dashurit e tyre nga COVID-19, si dhe ju uroj shërim të shpejtë të prekurve nga ky virus. Me sfidat e reja të sigurisë, që parashtron koha, modernizimi i pandalshëm i ushtrisë shqiptare është domosdoshmëri! Zoti i bekoftë ushtarakët shqiptarë dhe familjet e tyre! Lavdi Dëshmorëve dhe Heronjve të rënë për Atdhe e Flamur!”

Krijimi i FARSH- ngjarje madhore në historinë e popullit tonë

Gjeneralmajor prof.asoc.Bajram Begaj, mesazh urimi me rastin e 108-Vjetorit të krijimit të FARSH-së

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, me anë të një mesazhi ka uruar Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për 108 - Vjetorin e Krijimit: "Të dashur ushtarë, detarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë, pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë! Sot përkujtojmë me krenari 108 - Vjetorin e Krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Krijimi i FARSH përbën një ngjarje madhore në historinë e popullit tonë, e cila nxjerr në pah aftësitë shtetformuese të themeluesve të shtetit modern shqiptar.

Në këtë ngjarje historike, fillimisht ne nderojmë ata, të cilët me përpjekjet e tyre realizuan pavarësinë dhe bënë të mundur krijimin e ushtrisë shqiptare.

Me respekt të pafund, ne përulemi dhe kujtojmë me mirënjohje sakrificat dhe përkushtimin e të gjithë ushtarakëve, që kanë shërbyer dhe shërbejnë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht të atyre që sot ndodhen në krye të detyrës nëpër misionet jashtë vendit. Pa këto sakrificat, përkushtimin, djersën dhe gjakun e derdhur nga bijtë e bijat e kombit, pjesëtarë të FARSH, këto të fundit dhe vetë shteti shqiptar nuk do të ekzistonte. Viti 2020, ka qenë një vit, i cili do të kujtohet në histori, i mbushur plot me sfida jo vetëm për Shqipërinë dhe Forcën e Armatosur, por për të gjithë botën, kjo për shkak të pandemisë të shkaktuar nga virusi COVID-19. Forcat e Armatosura, si kurdoherë, kanë qenë përkrah institucioneve të shtetit shqiptar për përbashkëtimin e kësaj situatë, si dhe kanë ruajtur gatishmërinë e tyre operacionale dhe angazhimet në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Sot, siguria e vendit është një mision përtej fushëbetejës tradicionale, ku së bashku, duhet të tregojmë një kujdes të shtuar, për të qenë shembull në respektimin



e masave të rekomanduara ndaj COVID 19, për të ruajtur vetveten, kolegët, familjarët dhe gjithë popullin shqiptar, me qëllim tejkalimin e kësaj sfide dhe kthimin sa më shpejt dhe të lehtë në normalitet.

Me mirënjohjen dhe respektin më të thellë për shërbimin, sakrificat

dhe kontributin tuaj dinjitoz, dua t'ju përcjell urimet më të mira për ju dhe familjet tuaja. Shëndet e mbarësi në jetët tuaja! Suksese në misionin fisnik që kryeni!"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor prof. asoc. Bajram BEGAJ

108-vjetori i FA-së, ambasadorja Yuri Kim mesazh urimi:

Shpresojmë të forcojmë më tej gatishmërinë tonë të përbashkët




Ambasadorja e SHBA-ve, Yuri Kim iu është bashkuar urimeve me rastin e 108-vjetorit të lindjes Forcave të Armatosura Shqiptare. Përmes një postimi në Twitter diplomatja theksoi se SHBA është krenare që stërvitet dhe lufton së bashku me forcat shqiptare.

Mesazhi i Yuri Kim: "Gëzuar 108 vjetorin e lindjes Forcave të Armatosura Shqiptare. Ne jemi krenarë që stërvitemi dhe luftojmë së bashku forcat amerikane dhe shqiptare. Krahu për krahu. Ne shpresojmë të forcojmë më tej gatishmërinë tonë të përbashkët, bashkëpunimin dhe punën në ekip. Urime!"

Forca Detare do realizojë misionet në det sipas standardeve të NATO-s

Me marrjen e detyrës së re, Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, ka zhvilluar një sërë takimesh me atashetë ushtarakë të vendeve anëtare të NATO-s të atashuara në vendin tonë ku është diskutuar për nivelin e zhvillimit të deritanishëm dhe bashkëpunimin me forcat detare reciproke. Kështu Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, priti më datë 10 dhjetor 2020, në një vizitë kortezie atashëun ushtarak të Republikës së Italisë kolonel Nicola Piccolo në vendin tonë. Mbasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare, gjeneral brigade Xhebexhia theksoi marrëdhëniet e mira që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve dhe veçanërisht ndërmjet dy forcave detare, njëkohësisht e njohu ata me punën dhe përpjekjet që ka bërë efektiv i Forcës Detare për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e standardeve të NATO-s. Nga ana e tij kolonel Piccolo, falenderoi

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, priti atashëun ushtarak të Republikës së Italisë kolonel Nicola Piccolo



komandantin e Forcës Detare për mikpritjen dhe shprehu gatishmërinë e tij personale dhe të Forcave të Armatosura të Italisë për të vazhduar dhe shtuar bashkëpunimin në çdo fushë që të dy palët e shohin

me interes të përbashkët. Para pak ditësh Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, ka zhvilluar takime zyrtare edhe me atashetë ushtarakë të Turqisë dhe Rumanisë.

Bashkëpunim me Forcat Detare të Rumanisë

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, priti në një vizitë kortezie atashëun ushtarak të Republikës së Rumanisë kolonel Valerica Piroasca, në vendin tonë.

Mbasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare, gjeneral brigade Xhebexhia e falenderoi për ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm të Ushtrisë Rumune me Forcat tona të Armatosura, njëkohësisht i njohu ata me punën dhe përpjekjet, që ka bërë efektiv i Forcës Detare për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e standardeve të NATO-s.

Nga ana e tij Kolonel Piroasca, falenderoi Komandantin e Forcës Detare për mikpritjen dhe shprehu gatishmërinë e tij personale dhe

Forca Detare e angazhuar për të përmbushur standardet e NATO-s

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti atashëun ushtarak të Rumanisë, kolonel Valerica Piroasca



të Forcave të Armatosura të Rumanisë për të vazhduar dhe për të shtuar bashkëpunimin në çdo fushë, që të dy palët e shohin me interes të përbashkët. Fryma e miqësisë

tradicionale midis dy popujve tanë pasqyrohet, në bashkëpunimin midis dy ushtrive dhe flotave tona, nënvizuan gjatë takimit ushtarakët e dy vendeve.

Bashkëpunim me forcat detare të Turqisë

Gjeneral brigade Xhebexhia priti atasheun e Turqisë kolonel Kablay

Paraditen e datës 2 dhjetor, komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një vizitë kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë kolonel Muhamet Kablay në vendin tonë. Në këtë vizitë kortezie kolonel Kablay shoqërohej nga Komandanti i Njësisë Turke në Pashaliman kapiten i rangut të parë Erol Küçük.

Pas urimit të mirëseardhjes, gjeneral brigade Xhebexhia vlerësoi nivelin e bashkëpunimit të deritanishëm me Forcat e Armatosura Turke në përgjithësi, por në veçanti

me Forcën Detare. Ai shtoi se mbështetja me kurse dhe trajnime të vazhdueshme për efektivat tanë në Turqi, ka qenë një element shumë i rëndësishëm për sa i përket arsimimit të kadrove të Forcës Detare. Nga ana e tij Kolonel Kablay, falenderoi Komandantin e Forcës Detare për mikpritjen dhe shprehu gatishmërinë e tij personale dhe të Forcave të Armatosura të Turqisë për të vazhduar dhe shtuar bashkëpunimin në çdo fushë, që të dy palët e shohin me interes të përbashkët.



Koalicioni "Sentinel" në Gjirin Persik dhe Ngushticën e Harmuzit

Gjeneral brigade Xhebexhia, takim online me kundëradmiral Wood

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia zhvilloi një takim online me komandantin kundëradmiral Craig Wood. Gjatë takimit u diskutua mbi situatën aktuale në Gjirin Persik dhe Ngushticën e Harmuzit. Komandanti i Koalicionit "Sentinel" informoi komandantin e Forcës Detare mbi operacionin e kësaj task-force në muajt e fundit. Gjeneral brigade Xhebexhia nga ana e tij informoi komandantin e Sentinel mbi statusin e personelit të Forcës Detare që do t'i bashkohet task-force. Komandanti i FD e siguroi komandantin e Sentinel mbi mbështetjen e plotë që ka task-forca nga Shqipëria.



Gjeneral brigade Sallaku priti atasheun turk, kolonel Kablay

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku priti me 14 dhjetor në një takim kortezie atasheun e ri ushtarak të Turqisë, kolonel Muhamet Kablay. Gjeneral brigade Sallaku pasi i uroi mirëseardhjen kolonelit turk e falënderoi atë për mbështetjen që Turqia i ka dhënë Forcave tona të Armatosura e Komandës Mbështetëse ndër vite dhe në mënyrë të veçantë për ndihmën e madhe të donacioneve në kuadër të emergjencave civile (EC). "Ndihma e Turqisë për Forcat e Armatosura në përgjithësi e për Komandën Mbështetëse në veçanti ka dhënë një ndihmesë të madhe në kryerjen e detyrave dhe përballimin e operacioneve në mbështetje të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore, siç ishte rasti i tërmetit të vitit të kaluar si dhe situata e pandemisë globale Covid - 19", u shpreh gjeneral brigade Sallaku. Nga ana e tij, kolonel Kablay falënderoi për pritjen dhe njohjen e tij nga afër me Komandën Mbështetëse. Ai vlerësoi punën e kësaj komande për specifikën e saj në mbështetje jo vetëm të Forcave të Armatosura, por edhe të komunitetit në rast emergjencash civile. Kolonel Kablay shprehu gatishmërinë për vazhdimin e rritjen e bashkëpunimit mes Turqisë dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes edhe në të ardhmen. Takimi përfundoi me urime për festat e fundvitit dhe shkëmbimin e dhuratave për të dyja palët.

Kontingjentit VI i Forcave Speciale dhe Kontingjenti XIII i Këmbësoresë nisen drejt Kabulit

Më 7 dhjetor 2020, në mjesdiset ushtarake të aeroportit të Rinasit u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave të Kontingjentit VI paqeruajtës të Batalionit të Forcave Speciale dhe Kontingjentit XIII paqeruajtës të Batalionit II të Këmbësoresë që do të marrin pjesë në misionin "Resolute Support Mission" në Kabul, Afganistan.

Në këtë ceremoni mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë kolonel Muhammet Kelami Kablay. Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i cili ndër të tjera theksoi: "Ne, sot më shumë se kurdoherë, kemi statusin e një partneri të besueshëm, fakt ky i vërtetuar nga misionet e përbashkëta dhe aq më tepër nga pararendësit tuaj. Kam besim të plotë në vlerat tuaja morale, profesionale dhe padyshim e mbi të gjitha në përkushtimin tuaj. Ju shkoni sot në Afganistan, me dinjitet, shumë të vlerësuar, pasi atje do të gjeni emrin e mirë që kanë krijuar kolegët tuaj që po kryejnë aktualisht detyrat. Jam besimplotë se ju do t'ia dilni ashtu siç ia keni dalë gjithmonë në çdo detyrë, stërvitje apo trajnim, përvoja e fituar nga efektivet e Forcës Tokësore në misionet ndër vite ja u bën edhe me të lehtë kryerjen e detyrës."

Më tej fjalën e rastit e mori shefi i Shtabit të Përgjithshëm, i cili duke përcjellë përshëndetjet dhe urimet më të mira, edhe në emër të ministrit të Mbrojtjes ndër të tjera tha: "Ajo që ju keni bërë dhe vazhdoni të bëni për paqen dhe sigurinë në misionet jashtë vendit, është e një rëndësie të jashtëzakonshme. Unë, jam shumë i kënaqur nga performanca juaj në stërvitjen paradislokuese duke treguar disiplinë dhe profesionalizëm të lartë, jam i bindur



se me punën dhe me përkushtimin tuaj, do ia dilni mbanë. Duke parë vlerat tuaja, duke parë përkushtimin tuaj, ju sot na bëni krenarë, por ajo që unë kërkoj nga ju është që të respektoni veten tuaj, shokët dhe gjithë dispozitat ligjore."

Në përfundim të fjalës së tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj ju uroi suksese trupave ushtarake. Ceremonia u mbyll me dhënien e flamurit luftarak nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm.

Misioni "Resolute Support Mission" Afganistan

Kontingjenti shqiptar në Kabul, SHBA: "Medalje e Shërbimit të Meritës"

“Ushtarakët tanë vijnë të spikasin kudo ku ata shërbejnë”, - kështu e nis postimin e saj ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, teksa njofton se kolonel Ardian Lulaj dhe kontingjentet tona në Kabul u nderuan nga SHBA-ja me "Medaljen e Shërbimit të Meritës".

Kjo medalje ka ardhur ne shenjë nderimi për aftësitë dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të treguar gjatë shërbimit në misionin e NATO-s, Resolute Support. Postimi i Xhaçkës: Ushtarakët tanë vijnë të spikasin kudo ku ata shërbejnë! Përfaqësuesi më i lartë ushtarak shqiptar në Afganistan, kolonel Ardian Lulaj dhe kontingjentet tona në Kabul u nderuan nga SHBA-ja me "Medaljen e Shërbimit të Meritës", për aftësitë dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të treguar gjatë shërbimit në misionin e NATO-s, Resolute Support.





Forca Detare: Vlerësohet kontributi i nënoficerëve të SIHVD-së

“Certifikatë Mirënjohje” për kapter Teofik Gjoka dhe kapter Tonin Pepa

Të dy këta nënoficerë kanë lënë gjurmë si nënoficerë shembullorë e të disiplinuar, në nënrepartet e FD, përmbi 30 vjet

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua ditën e mërkurë, me 9 dhjetor 2020, një ceremoni e thjeshtë në respekt të dy nënoficerëve të Kompanisë SIHVD, kapter Teofik Gjoka dhe kapter Tonin Pepa, të cilët e mbyllën me nder karrierën e ushtarakut aktiv. Me këtë rast, Shefi i Shtabit FD, Kapiteni Rangut të I-rë, Sabri Gjinollari, në emër të Komandantit të FD, Gjeneral Brigade Ilir Xhepexhia, evidentoj përkushtimin dhe kontributin e nënoficerëve të lart përmendur në çdo detyrë që i është caktuar, duke i vlerësuar ata me “Certifikatën e Mirënjohjes”. Ndërsa Kapter Teofik

Gjoka, mbas një shërbimi disa vjeçar në Shërbimin Hidrografik, ju bashkua Kompanisë së Vëzhgimit Detar, kapter Tonin Pepa, ju bashkua kësaj kompanie, mbas një shërbimi disa vjeçar në ish Repartet bregdetare të rajonit Shëngjin-Lezhë. Të dy këta nënoficerë kanë lënë gjurmë si nënoficerë shembullorë e të disiplinuar, në nënrepartet e FD, përmbi 30 vjet. Në fund të dy nënoficerëve të nderuar ju urua shëndet në jetën e tyre civile. Tashmë, në Komandën e FD është krijuar traditë, nderimi dhe respektimi i të gjithë ushtarakëve, që për shkak të reformës, janë të detyruar të thonë: Lamtumirë armë!

Medalja “Joint Service Commendation Medal”

Gjeneral Tod D. Wolters, nderon Kapter Olsi Canin

Efektivët e Forcave të Armatosura spikasin me përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre në strukturat më të rëndësishme të NATO-s. Kapter Olsi Cani u nderua me medaljen “Joint Service Commendation Medal” nga komandanti Suprem i Fuqive Aleate në Evropë Supreme Headquarters Allied Powers Europe (SHAPE), gjeneral Tod D. Wolters, për shërbimin dhe bashkëpunimin e tij të shquar me Forcat e Armatosura të SHBA.



Ushtaraket në Misione Ndërkombëtare

Rreshtere Alketa Kaziu, midis 200 efektivave në misionet ndërkombëtare

Tashmë nuk është më tabu, edhe femrat ushtarake janë bërë pjesë e misioneve ndërkombëtare ku efektivat e Forcave të Armatosura janë të angazhuara në kuadër të NATO-s, OKB-së, etj. Një prej tyre është edhe rreshtere Alketa Kaziu, e cila para pak ditësh u nis drejt Kabulit-Afganistan, pjesë e Kontingjentit XIII paqëruajtës, të Batalionit të II të Këmbësorisë, të Forcave Tokësore. Kjo është përshëndetur edhe nga minis-



trja e Mbrojtjes Olta Xhaçka.

“Rreshtere Alketa Kaziu, nga Batalioni i II i Këmbësorisë të Forcës Tokësore, bashkë me kolegët e saj të kontingjentit të XIII shqiptar u nisën drejt Afganistanit si pjesë e misionit të NATO-s, Resolute Support. Sot 200 efektivë të FA-së shërbejnë në misione, që nga Afganistani e deri në Sudanin e Jugut. Vlerësimi për ta nga aleatët reflekton transformimin e madh, që po ndodh sot në FA, duke u bërë çdo vit e më shumë një forcë profesioniste e standardeve të NATO-s”,- shkruan ministria Xhaçka.

Analiza për vitin 2020 dhe prioritetet kryesore për vitin 2021

Më datë 23.12.2020 në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarit Bunavi, u zhvillua analiza vjetore e Akademisë së Forcave të Armatosura, me pjesëmarrjen online të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Gjeneralmajor Bajram Begaj, drejtorëve të drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm.

Analiza u drejtua nga komandanti i AFA Gjeneral brigade Albert Mullai me prezencën e drejtuesve të institucioneve vartësisë.

Në analizë u vlerësua puna e bërë si një aktivitet shumë intensiv për shkak të marrjes së statusit të veçantë, si institucioni i vetëm i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, ndryshimit të strukturës organizative, hapjes pas 10 vite ndërprerje të programit bachelor.

“Vijimi i punës për hartimin e statusit të AFA, ri akreditimin,

Prioriteti kryesor të punës për 2021: Hartimin e statusit të AFA, ri akreditimi dhe përfshirja në konceptin e arsimit profesional



përfshirja në konceptin e arsimit profesional të problematikave lidhur me situatën e pandemisë Covid-19 do jenë prioritetet kryesore të punës për 2021. Bachelori do të jetë në fokusin kryesor të

punës tonë”, - theksoj në fjalën e tij gjeneral Mullai. Gjeneral Begaj vlerësoi punën e bërë nga i gjithë personeli i AFA, duke theksuar se keni mbështetjen time maksimale për vazhdimin e punës.

Në ambientet e “Garnizonit Skënderbej”

Më 17 dhjetor 2020, në ambientet e “Garnizonit Skënderbej” u zhvillua ceremonia e dhënies së gradave për personelin e Akademisë së Forcave të Armatosura. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Gjeneral brigade Albert Mullai, zv/komandanti kolonel Fatmir Neziraj dhe drejtorët e drejtorive.

Hapja e ceremonisë u bë me leximin e urdhrat të ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për dhënien e gradave personelit oficer dhe nënoficerë.

Në AFA morën gradën e radhës 19 vetë nga këto gjashtë femra. “Marrja e gradës së radhës nga ana juaj është shpërblim i kontributit që keni dhënë në vijimësi në Forcat e Armatosura. Profesionalizmi dhe përkushtimi

Gradime për personelin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Marrja e gradës së radhës është shpërblim i kontributit të dhënë në vijimësi në Forcat e Armatosura



i shprehur në përditshmërinë e punës aty ku shërbeni, shpresoj që të shërbej si motivim për brezat

më të rinj në radhët e FA. Duke ju uruar për marrjen e gradës njëkohësisht dua t’ju shpreh urimet e mia për ju dhe familjet tuaja, gëzuar festat e fund vitit”, u shpreh gjeneral Mullai në fjalën e tij të përshëndetjes.

“Fundi i vitit shpërblen përkushtimin dhe profesionalizmin e më të mirëve në Forcat e Armatosura. Gra, vajza, burra e djem në të gjitha forcat dhe strukturat e FA bashkë me gradat e reja, morën mbi shpatulla edhe përgjegjësi më të mëdha”, shkruan ministrja Xhaçka ne facebook.



Komanda e Forcës Tokësore-garnizoni Zall-Herr

Gradohen 115 ushtarakë nga efektivat e Forcës Tokësore

Në Forcën Tokësore, për vitin 2020 u graduan 1 kolonel, 4 nënkolonel, 14 major, 12 kapiten, 4 toger, 3 kryekapter, 15 kapter, 13 rreshter, 49 tetarë

Paraditen e ditës së mërkurë, 16 dhjetor 2020, në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore në garnizonin e Zall-Herrit, u zhvillua ceremonia e gradimeve të personelit të Forcës Tokësore. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, komandantët e batalioneve si dhe personeli i graduar i Forcës Tokësore. Kjo ceremoni u hap me leximin e urdhrat të ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për dhënien e gradave personelit oficer dhe nënoficer të Forcës Tokësore.

Më pas fjalën e rastit e mori komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili pati nderin dhe kënaqësinë që të vendoste gradën e radhës efektiveve që ai drejton. Duke i uruar atyre suksese për gradimin e merituar ndër të tjera theksoi: "... arritjet, rezultatet e larta si dhe performanca që ju keni treguar me punën tuaj, u shpërblye sot me marrjen e gradës së radhës. Përparimi në gradë, mundëson vijueshmërinë e mëtejshme në karrierën tuaj si ushtarakë. Unë besoj se ky vlerësim, që vjen për ju sot, do të jetë motivim për të rritur përkushtimin dhe profesionalizmin tuaj çdo ditë, në detyrat ku ju shërbeni si pjesë e Forcës

Tokësore. Unë uroj që ky promovim sot të pasohet nga të tjerë në vitet në vijim të karrierës tuaj." Në Forcën Tokësore, për vitin 2020 u graduan 1 kolonel, 4 nënkolonel, 14 major, 12 kapiten, 4 toger, 3 kryekapter, 15 kapter, 13 rreshter, 49 tetarë. Zhvillimi i ceremonive të gradimeve, emërimeve të reja, transferimeve dhe daljeve në rezervë mbart vlera të veçanta, dëshmi e vlerësimit dhe njëkohësisht e respektit, që u bëhet personelit oficer, nënoficer, ushtar dhe civil në FT.

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare

Gradohen 19 oficerë dhe 23 nënoficerë

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare, u zhvillua ceremonia e gradimeve të personelit nënoficer, oficer të Forcës Detare. Personeli i graduar u përshëndet nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut të parë Ferdinand Kreshpani, i cili uroi dhe vlerësoi efektivat për arritjet dhe rezultatet e punës së tyre të vazhdueshme disa vjeçare. Ai shtoi më tej: "Unë shpresoj, që ky promovim juaj sot të pasohet nga të tjerë në vitet pasi karriera juaj do të vazhdojë. Forca Detare u është mirënjohëse për punën dhe shërbimin tuaj". Ceremonia vijoi me leximin e urdhrat të ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura mbi gradimet e reja dhe më pas në mënyrë simbolike u vendosën gradat personelit të sapo graduar. Në total në Forcën Detare, morën gradën e radhës 19 oficerë, 23 nënoficerë.



Filloi Kursi 45-të i Avancuar i Nënoficerit

Më datë 7.12.2020 në QAPN filloi Kursi 45-të i Avancuar i Nënoficerit, i përbërë nga 35 kursantë, ku 13 prej tyre janë femra. Pavarësisht situatës së vështirë që po kalojmë për shkak të pandemisë Covid-19, trupa mësimore e QAPN është e angazhuar maksimalisht në realizimin e kurseve të planëzuara vjetore, duke zbatuar me rigorozitet protokollin e masave ndaj pandemisë Covid-19. Ky kurs ka si qëllim përgatitjen e nënoficerit në rolin e zv/komandantit të togës në specialitetin përkatës. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën "Tetar". Gjatë këtij kursi për 8 javë me radhë, kursantët do të thellojnë njohuritë dhe përgatitjen ushtarake në këto module: Lider-ship, Rregullore-Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje Zjarri, Përgatitje Fizike.



Gradohen oficerë dhe nënoficerë të Garnizonit të Rinasit

Një numër i konsiderueshëm i personelit ushtarak të Forcës Ajrore është promovuar duke merituar gradën e radhës

Me një ceremoni të thjeshtë, në ambientet e jashtme të Komandës së Forcës Ajrore u zhvillua më 22 dhjetor 2020, ceremonia e dorëzimit të gradave, medaljeve të karrierës dhe certifikatë mirënjohje, për efektivin e strukturave të Forcës Ajrore të Garnizonit Rinasit.

Të pranishëm në aktivitet ishin zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, shefi i Shtabit dhe drejtuesit e strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit si dhe të gjithë ushtarakët aktivë dhe në rezervë të cilët respektivisht marrin gradat e radhës, medaljet e karrierës si dhe certifikatë mirënjohje për personelin ushtarak aktiv dhe ato në rezervë i cili ka plotësuar vitet e shërbimit në FA sipas ligjit.

Kolonel Pulaj në fjalën e tij falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen duke e cilësuar këtë ceremoni të thjeshtë por kuptimplotë pasi së pari, vijoi ai, do t'ij dorëzojmë gradat personelit ushtarak, të cilët me mund dhe djersë e kanë fituar këtë të drejtë që i jep Ligji dhe rregulloret në fuqi. Ai shprehu kënaqësinë që një numër i konsiderueshëm i personelit ushtarak të Forcës Ajrore është promovuar duke merituar gradën e radhës si dhe i uroi atyre suksese të mëtejshme në karrierë.

Në vijim të fjalës së tij përshëndetëse zëvendëskomandanti citoi se, krahas gradimeve, sot japim medaljet e karrierës dhe ato të mirënjohjes për personelin, i cili ka dhënë ditët më të bukura të tyre Forcës Ajrore duke i shprehur atyre mirënjohjen dhe falënderimet e përzemërta për punën e kontributin si dhe i inkurajoi ushtarakët aktivë për vijimin e punës me përkushtim e çuarjen përpara të Forcës Ajrore, ndërsa për ushtarakët në rezervë uroi integrimin dhe kontributin me statusin e ri në jetën civile.

Kolonel Pulaj mbylli fjalën e tij me urimet më të përzemërta për ushtarakët e promovuar në gradën e radhës, për personelin, i cili për shërbimin në Forcat e Armatosura meritoi medaljen e Karrierës si dhe



certifikatë mirënjohje për personelin i cili ka dalë në rezervë sipas ligjit duke i falënderuar dhe uruar atyre shëndet, gëzime, harmoni e suksese të mëtejshme në karrierë dhe në familjet e tyre.

Ceremonia vijoi me leximin e urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes

për dhënie grade dhe dorëzimin e gradave por edhe të medaljeve të Karrierës dhe ato të certifikatave të mirënjohjes për oficerët dhe nënoficerët e Forcës Ajrore të Garnizonit të Rinasit. Aktiviteti u mbyll me foto të ushtarakëve aktivë Forcës Ajrore dhe atyre në rezervë.

Në ambientet e Komandës Mbështetëse (KM)

Gradohen 64 ushtarakë, midis tyre një kolonel dhe dy nënkolonelë

Pas leximit të urdhrave të gradimit nga Shefi i Personelit n/kolonel Hyqmet Hoxha, një pjese të tyre iu vendos grada nga Komandanti i KM, Zëvendës Komandanti, Shefi i Shtabit dhe Komandantët e N/repartëve të KM. Më 17 dhjetor 2020, në Komandën Mbështetëse (KM) u zhvillua një ceremoni modeste për gradimet, ku në rang Komande u graduan një kolonel, dy nënkolonelë, pesë majorë, tetë kapitenë dhe pesëdhjetë e gjashtë nënoficerë nga të cilët dyzet e tetë tetarë dhe nëntë rreshterë. Me këtë rast Komandanti i Komandës Mbështetëse (KM) gjeneral brigade Ndrizim Sallaku falenderoi personelin e graduar për punën dhe impenjimimin e tyre maksimal në detyrë për realizimin e misionit në mbështetje të Forcave të Armatosura. "Në këtë ditë të veçantë për ju ndihem i nderuar, pasi nga dy grada madhore, një i përket KM dhe mendoj se jeni prezantuar mirë. Kjo për shumë nga ju nënkupton luftën e përpjekjet e përditshme tuaja që ju kanë dalluar në realizimin e detyrave. Shpresoj që ky të jetë një motivim më i madh për ju dhe e theksoj këtë sidomos për brezin më të ri siç janë kapitenët pasi hapësirat për ta në FA janë më të mëdha për të siguruar atë që nuk është dhe aq e lehtë jashtë këtyre mureve". Ceremonia u zhvillua nën respektimin e masave të rrepta të sigurisë.

Kursi i XVII-të "Komando"

Stërvitja komplekse 72 orëshe, testim i aftësive fizike dhe psikike

Stërvitja u krye në poligonin kombëtar të Bizës dhe është një nga pjesët më të vështira të kursit "Komando", marshim në këmbë, në distancën 25 kilometra me pajisje

"Kursi "Komando" ka hyrë në fazën e tij më sfiduese. Trupat që aspirojnë të bëhen pjesë e një ndër strukturave elitë të Forcave të Armatosura, po zhvillojnë stërvitjen sfilitesë, 72 orë pa ndërprerje, gjatë së cilës duhet të kalojnë sprova ekstreme fizike dhe psikologjike. Në stërvitjen, që po zhvillohet në Bizë, trupat po testojë aftësitë në marshimin në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 km, alpinizëm, goditje objekti, luftim i afërt apo mbijetesë", - shkruan ministrja Xhaçka ne facebook.

Ditën e enjte, 17 dhjetor 2020, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i shoqëruar nga komandanti i batalionit "Komando" kolonel Edmond Doda ka inspektuar nga afër kryerjen e stërvitjes komplekse 72 orëshe të kursit të XVII-të "Komando". Kjo stërvitje u krye në poligonin kombëtar të Bizës dhe është një nga pjesët më të vështira të kursit Komando pasi ka në programin e saj marshim në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 kilometra dhe sigurimin e ushqimit në natyrë (mbijetesë). Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji gjatë inspektimit nga afër të kësaj stërvitjeje përgëzoi efektivin e Instruktorëve për nivelin e lartë

të përgjegjësisë dhe seriozitetit të kryerjes së këtij kursi si dhe falenderoi kursantët e kursit të XVII-të "Komando" për vendosmërinë dhe shpirtin e sakrificës, që ata po tregojnë. Çdo gjë është e mundur kur ka frymë grupi dhe një objektiv të qartë për tu arritur. Unë shpresoj, që periudha që ju po kaloni gjatë kësaj stërvitjeje, t'ju shërbejë për tu rritur edhe më tepër profesionalisht, për të treguar se kur punojmë së bashku çdo gjë është e mundur. Por, besoj gjithashtu që ju do të vazhdoni të rriteni edhe më tepër nga ana profesionale, kur të përfundoni me sukses kursin "Komando" dhe të merrni beretën e kaltër", - tha ai.

Stërvitja komplekse 72 orëshe e kursit "Komando" ka për qëllim testimin e aftësive ekstreme fizike dhe psikike duke i bërë të aftë kursantët të përshtaten me mjedisin që i rrethon për të kryer me sukses çdo detyrë luftarake që mund t'i ngarkohet. Gjatë kësaj stërvitjeje u kryhen këto tema: marshim në këmbë, taktikat e njësisë të vogla, alpinizëm, prita, goditje objekti, luftim i afërt, mbijetesë, traversa topografike. E veçanta e kësaj stërvitjeje është se përveçse ngarkesës së madhe fizike dhe psikologjike janë zbatuar me sukses edhe të gjitha masat e rrepta mbrojtëse nga COVID-19.

Garda e New Jersey-it

Specialistët Amerikanë trajnojnë ushtarakët e KM-së

Në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse (KM), pas dy javësh trajnimit të 9 ushtarakëve të KM-së nga Specialistët Amerikanë të Gardës së New Jersey-it, përfundoi kursi "Rikonicioni i avancuar". Qëllimi i kursit ishte aftësimi i specialistëve xhenierë të KM për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD me ndihmën e pajisjes X-RAY dhe programit MFK (Mobile field kit). Këto pajisje të cilat janë donacione amerikane për xhenion, shërbejnë për skanimin e objekteve të dyshuara si IED, ose municioneve të ndryshme dhe bëjnë dallimin e lëndëve organike nga ato jo organike. Ky kurs ka një rëndësi të veçantë në rritjen e aftësive dhe zgjidhjen me sukses të detyrave EOD në Forcat e Armatosura Shqiptare.



Akademia e Forcave të Armatosura

Hapen kurset institucionale për oficerët e karrierës

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e hapjes së kurseve institucionale për oficerët e karrierës. Në ceremoni morën pjesë Komandanti i AFA gjeneral brigade Albert Mullai, trupa pedagogjike, komanduese, mbështetëse si dhe kursantët që do të ndjekin KKSHP, KLO.

Duke ju uruar mirëseardhjen në kurse, gjeneral Mullai, shprehu vlerësimet maksimale për çdo kursat të përzgjedhur për të vazhduar studimet në AFA. "Vini në AFA në një situatë shumë të vështirë për shkak të pandemisë që po kalojmë. Jeni oficerët më të spikatur që kanë FA te përzgjedhur për të vazhduar studimet e metejshme. Jeni ju, gjenerata që do të drejtoni për një dhjetë vjeçar Forcat e Armatosura dhe do të shërbeni si model për studentët e rinjë për oficerë. Shfrytëzoni këtë kohë në Akademi për të studiuar, duke ofruar eksperiencën që keni marrë aty ku keni shërbyer brenda dhe jashtë vendit", u shpreh në fjalën e tij, gjeneral Mullai. Në këto kurse do të vijojnë studimet në KKSHP 56 kursantë dhe KLO 19 kursantë, nga këta 16 janë femra. Gjithashtu pjesë e këtyre kurseve institucionale janë edhe dhjetë kursantë të FSK. Nga ana e stafit pedagogjik kursantët u njohën me programin mësimor sipas grupeve dhe mënyrën e zhvillimit. Mësimi do të zhvillohet në grupe të vogla mësimore dhe online.



Baza Ajrore Farkë, pjesa e nderuar e Forcave Ajrore Shqiptare

Mirënjohje e respekt për të gjithë brezat e pilotëve, teknikëve, specialistëve, ushtarakëve dhe civilëve të cilët kanë kontribuar deri në ditët e sotme në këtë njësi

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj uron efektivin e Bazës Ajrore Farkë me rastin e 53-Vjetorit të Krijimit të saj:

"Të nderuar ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe punonjës të Bazës Ajrore Farkë! 6 Dhjetori është dita për të përkujtuar me krenari Krijimin e Bazës Ajrore Farkë dhe falenderuar e shprehur mirënjohjen dhe respektin për të gjithë brezat e pilotëve, teknikëve, specialistëve, ushtarakëve dhe civilëve të cilët kanë kontribuar deri në ditët e sotme në këtë njësi. Me gatishmërinë dhe angazhimin tuaj të përhershëm, ju keni përmbushur jo vetëm misionin tuaj të rëndësishëm në mbështetje të Forcave të Armatosura, por keni kryer me përkushtim detyra tepër të vështira në mbështetje të popullsisë

në rastet e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore duke treguar aftësi të larta operacionale dhe profesionale. Në mënyrë të veçantë, sot është dita për të kujtuar dhe nderuar me respekt të Rënët në krye të detyrës, të cilët janë shembulli i

sakrificës dhe vetëmohimit në përmbushje të misionit dhe shërbimit ndaj qytetarëve. Jam shpresëplotë se ju efektivat e Bazës Ajrore Farkë do të vazhdoni traditën e një historie të suksesshme. Urime për Ditën e Krijimit të Bazës Ajrore Farkë!



Historiku i Bazës Ajrore Farkë

Para pak ditësh u kujtua 53 vjetori i Bazës Ajrore Farkë, ku si datëlindje është 6 dhjetori 1967. Baza Ajrore Farkë mban peshën kryesore në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të situatave të emergjencës në vendin tonë. Në korrik 1956, pilotët dhe teknikët u dërguan në ish-Bashkimin Sovjetik për t'u trajnuar në përdorimin e helikopterëve. Në qershor 1957, u krijua Njësia e Transportit Ushtarak nr. 5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa aeroplanë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2.

Më 4 shtator 1957, mijëra njerëz në Tiranë panë duke fluturuar një helikopter në qiell për herë të parë në vendin tonë. Helikopteri i pilotuar nga Peço Polena fluturoi mbi itinerarin Tiranë-Shkodër-Tiranë. Fluturimet me helikopterë MI-4 vazhduan duke përmbushur detyra të veçanta, veçanërisht në situatat e dimrit në vitet 1958, '59, '60, në kushte shumë të vështira të motit.

Në vitin 1967, rreth 30 helikopterë të rinj MI-4 të prodhuar në Kinë u përfshinë në këtë njësi. Kjo njësi u emërua "Regjimenti i Helikopterëve" më 6 dhjetor 1967 dhe komandant i saj u emërua Lulo Musaj. Pra, 6 dhjetori i vitit 1967 është data e krijimit të Bazës Ajrore Farkë. Regjimenti përfshinte tre skuadrilje të helikopterëve MI-4, një njësi për të riparuar helikopterët, pistën për helikopter, që lejonte ngritjen dhe uljen në të njëjtën kohë të disa helikopterëve, kazermat dhe kushtet normale për personelin, rojet dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur detyra.

Baza Ajrore Farkë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në kryerjen e trajnimeve të ndryshme ushtarake të asaj kohe, por edhe për të ndihmuar popullsinë në raste emergjente civile, veçanërisht në raste përmbytjesh, zonash të bllokuara malore nga bora, tërmete

Shumica e personelit teknik dhe pilot është kualifikuar në shkolla dhe njësi perëndimore si në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretëri të Bashkuar



apo edhe në kohë krize.

Kjo bazë ka marrë pjesë gjithashtu në disa stërvitje, stërvitje të Forcave Ajrore, ose stërvitje të përbashkëta me forcat e njësisë të tjera të Forcave të Armatosura, duke treguar cilësi dhe nivel të lartë të trajnimit të fluturimit.

Për të kryer misionin e saj, personeli i kësaj baze është trajnuar intensivisht për të mbajtur në gatishmëri të vazhdueshme teknikën ajrore, për të përmbushur detyra të tilla si, transportimin e trupave, operacionet e kërkimit dhe shpëtimit (SAR), shpërndarjen e ndihmës ushqimore, ose transportimin e pacientëve në emergjencat civile. Në vitet e fundit, infrastruktura bazë është përmirësuar ndjeshëm kryesisht për shkak të ndihmës së dhënë nga Aleatet.

Personeli i Bazës Ajrore Farkë është kualifikuar për të përmbushur standardet dhe misionin e saj. Kjo bazë është një simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në stërvitje të përbashkëta, ku atje pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesion-

alizëm duke koordinuar veprimet për të përmbushur misionin.

Çdo vit, kryen mbi 500 fluturime në operacione humanitare për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për të transportuar të sëmurët, kundër zjarreve, transportin e ndihmave humanitare, në mbështetje të komunitetit gjatë përmbytjeve, etj. Treguesi i vërtetë dhe i prekshëm i të gjithë shqiptarëve ishte kontributi i dhënë në vitet e fundit gjatë përmbytjeve në Shkodër, ku përkundër kushteve të papërshtatshme të motit, pilotët ndihmuan njerëzit. Pilotët e bazës ajrore janë trajnuar që të jenë në gjendje të kryejnë operacione ajrore në kushte të ndryshme të motit dhe të ndërveprojnë me ushtritë e tjera aleate të NATO-s. Shumica e personelit teknik dhe pilot është kualifikuar në shkolla dhe njësi perëndimore si në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretëri të Bashkuar. Baza Ajrore Farkë mban peshën kryesore në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të situatave të emergjencës në vendin tonë.

Ish-ushtarakët në pension nuk janë më debitorë ndaj shtetit

Falën “detyrimet” e ish-ushtarakëve ndaj sigurimeve shoqërore

Mbi 800 familje ushtarakësh përfitojnë 111 milionë lekë të reja të falura duke gjetur kështu drejtësinë e munguar

Më 17 dhjetor 2020, Parlamenti Shqiptar, i dha fund kalvarit të gjatë dhe absurd të ish ushtarakëve në pension, të cilët për faj të shtetit u klasifikuan “debitor” ndaj, po vetë shtetit, konkretisht Sigurimeve Shoqërore. Kjo u bë e mundur me miratimin nga Parlamenti të Projektligjit “Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi”, -siç u shpreh në fjalën saj para deputetëve në parlament, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, se kjo “shënon mbylljen e një kalvari të stërzgjatur, të një prej atyre historive tipike të tranzicionit, ku shteti krijonte situata tmerrësisht të koklavitura, që më pas binin mbi kurrizin e njerëzve duke shkaktuar stres e lodhje e stërmundim për vite e vite me radhë”.

“Më në fund, tha Xhaçka, pas një kohe të gjatë mundimi, iniciativash gjysmake e sorollatje rrugëve të gjykatave, mbi 800 familje ish-ushtarakësh gjejnë drejtësinë e munguar. Ka qenë një situatë vërtet absurde, ku në një rën anë për faj të shtetit, ish-ushtarakët kanë marrë pensione suplementare, e në anën tjetër një vendim gjykate i detyronte këto pensione si një gabim, e



i shpallte ish-ushtarakët në pension debitorë ndaj shtetit duke iu kërkuar të kthenin pagesat suplementare për vite e vite”.

“Imagjinoni pra, tha ajo, një grup pensionistësh dhe sidomos një grup si ish-ushtarakët, që kanë qenë në fakt ndër kategoritë që janë viktimizuar më shumë nga gjithë historia e tranzicionit, për të mos folur pastaj për përndjekjen me të cilën janë trajtuar ata nga qeveria paraardhëse, papritur u shpallën debitorë ndaj shtetit e duhet të kthenin miliona lekë mbrapsht.

Me miratimin e këtij projektligji, qeveria shqiptare do të tërhiqet nga 874 procese gjyqësore të ndjekura pikërisht për shkak të një detyrimi absurd të imponuar nga Gjykata e

Lartë vite më parë, e të mbështetur në një skemë sigurimi shoqëror suplementar të vitit 1996 të ndryshuar shtatë herë deri në ditën që po flasim”.

Në vazhdim, ministrja Xhaçka tha se: “nëpërmjet këtij projektligji, 800 familjeve të ish-ushtarakësh u falën rreth 111 milionë lekë të reja si detyrime ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke vënë në vend dinjitetin e një kategorie shumë të nderuar të shoqërisë shqiptare, siç janë ushtarakët. Ne kemi punuar shumë me shoqatat e ish-ushtarakëve për të gjetur një zgjidhje. Qeveria ka punuar shumë, sepse ky ka qenë një premtim që u kemi bërë ish-ushtarakëve. Por nuk ka qenë

aspak e lehtë. Unë sot dua të falenderoj kryetarin e Kuvendit, z. Ruçi, i cili ishte nismëtari i këtij projektligji e që njëherësh ka qenë vazhdimisht një nga mbështetësit kryesorë të gjetjes së një zgjidhje për këtë problem. Mbështetja dhe angazhimi i tij personal siguron që ka qenë një ndihmë e madhe për të gjithë ne në adresimin e këtij problemi.

Me dakordësinë edhe të Ministrisë së Financave, historia e detyrimeve të ish-ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, e famshmjia çështje e borxhit të pensioneve të ish-ushtarakëve, fatmirësisht merr sot një zgjidhje. Me këtë projektligj mbyllet njëherë e mirë kalvari, që në fakt ishte i tepërt, për të gjithë ata burra e gra, që i kanë shërbyer këtij vendi, kanë sakrifikuar për sigurinë e tij, por që deri më sot nuk u trajtuan siç e meritonin.

Unë jam krenare, që arritëm t'i japim më në fund zgjidhje kësaj çështje, e cila nuk ishte thjesht financiare, por ishte po aq edhe një çështje dinjiteti njerëzor e respekti për këtë kategori. Dhe nëse hedh sytë prapa, besoj që ekziston sot një kontrast shumë i qartë në mënyrën sesi shteti shqiptar i trajton ushtarakët e ish-ushtarakët sot, me mënyrën sesi janë trajtuar deri dje. Sepse duhet ta themi që ky nuk është vendimi i parë i kësaj natyre që merr kjo qeveri. Vetëm pak kohë më parë, ne miratuam së bashku vendimin për rikthimin e trajtimit financiar për ushtarakët, duke rritur ndjeshëm të ardhurat për familjet e afro 5 mijë ushtarakëve aktivë e duke dërguar kështu edhe një mesazh solidariteti e respekti për burrat e gratë në uniformë.

Miratimi i Projektligjit "Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, vjen si një akt drejtësie sociale, si përmbushje e një detyrimi të shtetit shqiptar ndaj ish-ushtarakëve, por edhe si një përmbushje e një zotimi, që të gjithë ne kemi marrë vite më parë ndaj kësaj kategorie".

NË AMBIENTET E KOMANDËS SË FORCËS AJRORE, NË RINAS

Aktivitet festiv me vajzat e Dëshmorit të Atdheut, kapiten Florian Delia

Forca Ajrore do të kujtojë gjithmonë me nderim dhe respekt punën dhe veprën e Dëshmorëve të Saj, si dhe do të ketë gjithmonë vëmendjen tek familjet e tyre kryesisht tek vajzat Fjolla, Klea dhe Jehona që janë në moshën e rritjes

Paraditen e dates 16 dhjetor 2020, në ambientet e Komandës së Forcës Ajrore, në Rinas u zhvillua aktiviteti festiv me vajzat e Dëshmorit të Atdheut Kapiten Florian Delia me rastin e festave të fundvitit dhe ditëlindjes së vajzës së vogël Fjolla, e cila në fillim dhjetori mbushi 8 vjeç.

Të pranishëm në aktivitet ishin zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, përfaqësues të institucioneve të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit si dhe vajzat e Dëshmorit të Atdheut Kapiten Florian Delia të shoqëruara nga z. Jahja Delia, babai i Dëshmorit.

Kolonel Pulaj në fjalën e mirëseardhjes e cilësoi këtë ceremoni simbolike dhe domethënëse në respekt të Dëshmorit të Atdheut Florian Delia duke theksuar se Forca Ajrore do të kujtojë gjithmonë me nderim dhe respekt punën dhe veprën e Dëshmorëve të Saj, si dhe do të ketë gjithmonë vëmendjen tek familjet e tyre kryesisht tek fëmijët që janë në moshën e rritjes.

Më pas, zëvendëskomandanti në emër të personelit të Komandës dhe

institucioneve të Garnizonit të Forcës Ajrore uroi Fjollën, Klean dhe Jehonën për festën e Vitit të Ri duke i dorëzuar njëkohësisht atyre dhuratat që stafi i Komandës kishte përgatitur për vajzat e vogla të Dëshmorit.

Në vijim, babai i Dëshmorit falënderoi Komandën e Forcës Ajrore për kujtesën, surprizën e vlerësimin e vajzave të Floranit në prag të festave të fundvitit si dhe për urimin telefonik nga Kolonel Ylli Pulaj me rastin e ditëlindjes së Fjollës në fillim të dhjetorit.

Aktiviteti u mbyll me një foto të përbashkët dhe me një pritje në zyrën e Kolonel Pulaj, i cili shprehu interesimin e Tij mbi shëndetin dhe ecurinë në shkollë të vajzave të Dëshmorit në këtë situatë pandemie duke i siguruar ata që Forca Ajrore e ka gjithmonë derën e hapur për ti mbështetur e përkrahur sipas mundësive. Gjithashtu zëvendëskomandanti i uroi vajzat Fjollën, Klean dhe Jehonën të ecin në gjurmët e babait të tyre, e njëkohësisht Dëshmorit të Atdheut Kapiten Florian Delia.



Ushtarakët tanë në Qendrën e Ekselencës së NATO-s, Romë-Itali

Nënkolonel DËFRIM HAXHIJA*

Dega e Mësimeve të Nxjerra, e Qendrës së Ekselencës së NATO-s "Security Force Assistance" në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Psikologjisë Ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Italiane dhe të mbështetur nga disa vende anëtare të NATO-s dhe ato partnere, po punon në një projekt studimi i titulluar "SFA Operator Profile", duke grumbulluar nëpërmjet intervistimit, përvojat e shumë grave dhe burrave nën uniformë, të cilët kanë shërbyer në mbarë botën si Këshilltarë, Mentorë dhe Trajnues, në mënyrë që të hartojë një profil unik të operatorit të Forcës Asistuese për Siguri (Security Force Assistance-SFA).

Objektivat e këtij projekti janë: Përcaktimi i përshkrimit të pozicionit (procesit) të punës për operatorët SFA (Këshilltarët, Mentorët dhe Trajnuesit) në lidhje me emërtimin, përgjegjësitë dhe detyrave specifike të tyre; Identifikimi dhe analizimi i procesit dhe procedurave të përzgjedhjes së operatorëve SFA nga vendet anëtare dhe ato partnere të NATO-s; Identifikimi dhe analizimi (nëse janë aplikuar) i kriterëve për aftësinë dhe performancën e operatorëve SFA për të kryer me sukses misionin dhe detyrën; Analizimi i kompetencave dhe përgjegjësiwe thelbësore të operatorëve SFA; Identifikimi dhe analizimi i procesit dhe llojit të trajnimit dhe stërvitjes së zhvilluar me peratorët SFA nga vendet anëtare dhe ato partnere të NATO-s, para dislokimit të tyre në mision; Analizimi i metodave për krijimin e rrjetit të bashkëpunimit profesional nga operatorët SFA

“ Ushtarakët e FA me përvojë në misionet e mbështetjes të paqes, intervistohen online nga Qëndra e Ekselencës të NATO-s "Security Force Assistance", Itali



gjatë kryerjes së misionit, detyrës në teatrin operacional (ZO); Identifikimi i boshllëqeve dhe mangësive doktrinale në fushën e Forcës Asistuese për Siguri (Security Force Assistance – SFA).

Produkti përfundimtar i këtij projekti, do të jetë publikimi i një raporti analitik me rekomandime dhe konkluzione lidhur me: Definicionin e standardizuar për profilin e operatorit të Forcës Asistuese për Siguri (Security Force Assistance-Operator Definition); Formulimine formatit të përshkrimit të vendit/ pozicionit/procesit të punës/detyrës së operatorit SFA; Standardizime të procesit të selektimit dhe rekrutimit të personelit për dislokim në misionet SFA të drejtuara nga NATO, OKB, BE etj; Rekomandime

për përmirësimin e programve, korrikulave dhe tematikave për procesin e edukimit, trajnimit dhe stërvitjes para-dislokuese të këtij personeli; Rekomandime për standardizimin e kriterëve të vlerësimit të performancës për operatorët SFA; Rekomandime për rishikimin e doktrinës dhe përgatitjen e manualeve fushore për të plotësuar mangësitë dhe boshllëqet e konstatuara në referencat dhe materialet studimore për përgatitjen e tyre.

Ashtu siç u përmend më sipër, ky projekt bazohet kryesisht në të dhënat e grumbulluara dhe analizuar nga përvoja e jetuar e personelit ushtarak dhe civil, që ka asistuar dhe shërbyer përkrah Forcave Lokale të Sigurisë në misionet e NATO-s, OKB dhe BE.

Vendi ynë, si vend anëtar i Aleancës si dhe një nga vendet themeluese dhe kontribuese të Qendrës së Ekselencës, është përfshirë në këtë projekt studimi dhe do të përfitojë nga produktet e tij. Lidhur me këtë në datë 16.12.2020, një personel ushtarakësh nga Forcat tona të Armatosura, të cilët kanë shërbyer në misione si Këshilltarë, Mentorë dhe Trajnues, u intervistuan nga grupi i punës i këtij projekti. Aktiviteti u krye virtualisht online për arsye të situatës pandemice covid-19. Ushtarakët tanë shpalosën eksperiencat e tyre në misione dhe diskutuan me profesionalizëm të lartë shumë çështje duke rekomanduar ide dhe koncepte tepër të vlefshme për këtë projekt.

Deri tani nga grupi i punës, janë intervistuar personeli ushtarak dhe civili dislokuar në rreth 18 teatro të ndryshme operationale në vendet pritëse (HN) post-konfliktuale apo të brishta (rreth 100 operatorë të intervistuar dhe së bashku me përgjigjet e pyetësorëve rreth 220 rekorde personale), duke u fokusuar kryesisht në aspektet që lidhen me misionin dhe performancën e tyre. Drejtuesit e këtij projekti patën mundësinë të perceptojnë dhe analizojnë përmes kujtesës së operatorëve SFA realitetin e ndërveprimit ndërmjet qasjeve dhe qëndrimeve të ndryshme, me synimin epërbashkët për të evidencuar praktikatat më të suksesshme dhe mënyra konkrete për kapërcimin në të ardhmen të barrierave të hasura prej tyre.

Çdo përvojë që ka ofruar edhe një operator i vetëm, do të jetë pjesë e raportit përfundimtar të projektit, me kushtin e vetëm për të analizuar edhe perspektivën e tyre, duke e zhvillimuar kështu projektin mbi bazën një fryme bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse.

Të gjitha përvojat e mbledhura prej përgjigjeve nga intervistat dhe pyetësori i vënë në dispozicion, drejtuan grupin e punës së këtij projekti gjithashtu, të fokusojdhe thellojë

studimin në disa sfida dhe drejtime të reja, të cilat janë:

- Cilat janë ndryshimet midis këshilltarit, mentorit dhe trajnuesit?
- Si mund ta mbështesim dhe përmirësojmë procesin e përzgjedhjes dhe trajnimit të operatorit SFA para dislokimit në mision?
- Njohja e kulturës, vetëdija (ndërgjegjësimi) kulturore apo përshtatshmëria kulturore: cila do të jetë fjala kyçe për të përcaktuar një kompetencë thelbësore për atë që asiston dhe punon së bashku me Forcat Lokale të Sigurisë të vendit pritës (Host Nation-HN)?



- A është Ndjeshmëria (Empatia) një nga "armët" kryesoretë aftësisë së një operatori SFA për të qenë i suksesshëm në krijimin e marrëdhënieve miqësore me personelin në vendin pritës?

Këto dhe disa pyetje të tjera hipotetike po drejtojnë studimin në vazhdim, duke stimuluar debatin e grupeve të interesit dhe duke mbajtur të përqendruar dhe motivuar grupin e punës në hartimin dhe botimin e Raportit përfundimtar. E ardhmja dhe qëllimi ambicioz mbas publikimit të raportit është krijimi i një komunitet interesi, i cili do të kishte operatorin/specialistin e SFA si pikë qendrore, në shërbim dhe përfitim të komandave dhe vendeve të NATO-s e ato partnere. Më konkretisht ky synim konsiston në krijimin në të ardhmen të një bërthame kyçe diskutimi duke zhvilluar, ndarë dhe ofruar zgjidhje të prekshme për problemet dhe boshllëqet e konstatuara në të shkuarën dhe përmirësimin

e profilit dhe performances së operatorëve SFA në operationet dhe misionet e ardhshme të drejtuara nga NATO dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Kjo është edhe arsyeja që ky Raport mendohet të jetë një dokument i rishikueshëm "live document", duke e përditësuar atë me analiza dhe rekomandime koherente.

"Security Force Assistance" është struktura më e re e akredituar nga NATO dhe e 25-ta në rrejetin e qendrave të ekselencës të krijuara në vende të ndryshme anëtare të Aleancës dhe krijimi i saj erdhi si domosdoshmëri në mbështetje të

Konceptit të ri Strategjik të Aleancës. Shqipëria është shteti i parë që mbështeti fuqishëm iniciativën italiane dhe së bashku me Slloveninë arriti të jetë një nga nënshkruesit e parë të Memorandumit të Mirëkuptimit më 18 dhjetor 2017, duke bërë të mundur që të konvergojnë interesat kombëtare në një drejtim me ato të Aleancës dhe të ndërmarrin një linjë të përbashkët veprimi. Në Norfolk, Virxhinia të SHBA, u firmos me 18 dhjetor 2017 ngritja e qendrës së 25 të ekselencës së NATO-s, me seli në Romë.

Në ditën e firmosjes së Memorandumit, 18 dhjetor 2017, Gjenerali i NATO-s Denis Mericer, përshëndeti vendet e përfshira në krijimin e kësaj qendre të rëndësishme të ekselencës duke vënë në dukje se "qendrat tona të ekselencës janë të një rëndësie kyç për përmirësimin e bashkëveprimit të aleatëve dhe partnerëve, ku Transformimi i Komandës së Aleatëve luan një rol koordinativ. Jam i bindur se kjo qendër e re ekselence do ta përmbushë misionin e saj ambicioz".

Misioni i kësaj qendre ekselence është përmirësimi i efektivitetit të NATO-s në promovimin e stabilitetit dhe të përpjekjeve riorganizuese për skenarët e mundshëm të konflikteve dhe të postkonflikteve si edhe për të siguruar një mundësi unike për aleancën, vendet anëtare dhe partnere në fushën e Asistencës së Forcave të Sigurisë.

Vendim i Këshillit të Ministrave

Komiteti i Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Këshilli Ministrave, në fund të muajit nëntor 2020, ka miratuar vendimin, "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimit ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të Mbrojtjes Civile". Vendimi është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave.

Sipas vendimit, pranë Këshillit të Ministrave krijohet e funksionon Komiteti i Mbrojtjes Civile (në vijim, KMC), i cili është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë.

KMC-ja kryesohet nga ministri i Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka dhe ka në përbërje: ministrin e Brendshëm; ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme; ministrin e Financave dhe Ekonomisë, ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë; ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; ministrin e Turizmit dhe Mjedisit; ministrin e Drejtësisë; ministrin e Kulturës; drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; drejtorin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore; drejtorin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës

“Komiteti i Mbrojtjes Civile i cili është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile kryesohet nga ministri i Mbrojtjes.



Mjekësore; kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Në varësi të nevojave, në mbledhjet e KMC-së ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, drejtues të strukturave qendrore, organizata joqeveritare etj.

KMC-ja mbledhet, sa herë gjykohet e nevojshme nga kryetari i tij, për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave në bashkërendimin e punës për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive dhe mbrojtjen civile. Të drejtën e propozimit për thirrjen e mbledhjes së KMC-së, përveç kry-

etarit të tij, e ka edhe çdo ministër, sipas fushës së përgjegjësisë dhe llojit të fatkeqësisë.

KMC-ja zbaton politikat që kanë të bëjnë me vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror, Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe, nëpërmjet ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, propozon ndryshime, apo përditësime të tyre.

KMC-ja është autoriteti më i lartë i përhershëm që bashkërendon e koordinon veprimtaritë dhe aktivitetet ndërinstytucionale të

institucioneve e të strukturave dhe të gjitha subjekteve të përfshira në mbrojtjen civile. KMC-ja, me kërkesë të prefektit, në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 (tetë) % të buxhetit të bashkisë, merr vendim për kompensimin e dëmeve nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Pranë AKMC-së ngrihet e funksionon sekretariati teknik i KMC-së, i cili është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe për njoftimin e anëtarëve të KMC-së për mbledhjen e radhës, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të saj. Përbërja e sekretariatit teknik të KMC-së përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Çdo ministër është përgjegjës për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në fushën e përgjegjësisë shtetërore të institucionit që drejton, nëpërmjet sektorit për mbrojtjen civile. Ministrinë hartojnë plane, programe e dokumente të tjera që kanë për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas llojit të veprimtarisë e përgjegjësisë së tyre.

AKMC-ja koordinon në mënyrë të përqendruar shpërndarjen e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore, të caktuara për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.

10. Sektorët për mbrojtjen civile pranë ministrive duhet të zbatojnë me shpejtësi dhe efektivitet kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.

Sektorët për mbrojtjen civile në ministrinë përkatëse aktivizojnë, me kërkesë të AKMC-së, kapacitetet e parashikuara për emergjencë civile, për të reaguar me shpejtësi dhe efektivitet në rastin më të parë të mundshëm, por asnjëherë më vonë se 2 (dy) orë. Në situatat e emergjencave civile, komunikimi ndërinstytucional mbahet duke përdorur kanalet zyrtare të komunikimit. Në rastet e komunikimit verbal, sektorët për mbrojtjen civile pranë ministrive regjistrojnë dhe ruajnë përmbajtjen e bisedave, të njoftimeve apo të kërkesave të marra e të dhëna përmes

përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit. Institucionet dhe strukturat operacionale kryesore shtetërore, përgjegjëse për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive, janë ato të përcaktuara në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat angazhohen menjëherë me kërkesë të AKMC-së.

Për përballimin e emergjencave civile me specifika të veçanta, me kërkesë të AKMC-së, mund të angazhohen edhe autoritete e institucione të tjera shtetërore, përveç atyre të parashikuara në lidhjen 1 të këtij vendimi.

Institucionet e strukturat vendore, që bashkëpunojnë me insti-

bashkitë brenda territorit administrativ të tij për planifikimin pranë tyre të strukturave të përhershme të planifikimit e të mbrojtjes civile. Komunikimi me publikun, në rastet e fatkeqësive natyrore/fatkeqësive, kryhet nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile.

Vendimi nr.965, datë 2.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për bashkëpunimin ndërinstytucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave", shfuqizohet. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastruk-



tucionet dhe strukturat qendrore dhe të tjera për mbrojtjen civile, janë komisionet e mbrojtjes civile në nivel qarku e bashkie, të cilat veprojnë nën drejtimin e prefektit të qarkut e të kryetarit të bashkisë. Në përbërje të strukturës së administratës së prefektit funksionon sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile. Prefekti bashkërendon me

turës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe të gjitha institucionet, sipas lidhjes 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Struktura dhe niveli i pagave për personelin mjekësor në FA....

Më datë 24 dhjetor 2020, Qeveria ka miratuar vendimin "Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Ushtarak të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura", të ndryshuar", kjo në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave.

Kështu në vendimin nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon: "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës".

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon: "1. Në fushën e veprimtarisë të këtij vendimi përfshihen: a) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit



të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë; b) personeli teknik i shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë; c) personeli mjekësor, punonjësit e tjerë civilë me arsim të lartë dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës; ç) personeli mjekësor ushtarak në strukturat e Forcave të Armatosura, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (roje, gatishmëri, urgjencë); d) personeli mjekësor civil dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes; dh) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes; e) personeli mjekësor dhe personeli teknik i shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës.". c) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Struktura dhe nivelet e pagave për: a) punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga

"specialist" deri në "titullar institucioni", në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet rajonale, në spitalet psikiatrike dhe në spitalet bashkiake, janë sipas lidhjes nr.1/AP që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; b) personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; c) nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; ç) personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; d) personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; dh) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kom-

bëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; e) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; ë) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; f) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; g) punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; gj) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr.1, kreu 1.10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; h) personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës, janë sipas lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; i) personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; j) personelin teknik të shkencave mjekësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes, si dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr.2 me kërret përkatës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë

përbërëse e tij.”.

ç) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon: “3. Paga e grupit (kolona 1 e lidhjes nr.1 me kërret përkatës, kolona 1 e lidhjes nr.2 me kërret përkatës, kolona 3 e lidhjes nr.6, kolona 1, e lidhjes nr.7, kolona 1, e lidhjes nr.8 dhe kolona 1 e lidhjes nr.9), përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. d) Në fund të pikës 6 shtohen fjalët “... lidhjes nr.8 dhe lidhjes nr.9.”. dh) Në fund të pikës 7 shtohen fjalët “... lidhjes nr.5, lidhjes nr.6 dhe lidhjes nr.8.”. e) Pika 9/2 ndryshohet, me këtë përmbajtje: “9/2. Për punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore: a) kur punojnë brenda rrethit të tyre,

të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës që shërbejnë pranë Institutit të Shëndetit Publik, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është 70 000 lekë në muaj.”. f) Pikat 15 dhe 15/1 shfuqizohen. 2. Në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime: a) Në lidhjen nr.6/6 emërtesa “Mjek në strukturat e Forcave të Armatosura” shfuqizohet. b) Në lidhjen nr.8/1 emërtesa “ Mjek” shfuqizohet. 3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi



por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 3 000 lekë në muaj. b) kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 4 000 lekë në muaj.”. ë) Pas pikës 10 shtohen pikat 10/1 dhe 10/2, me këtë përmbajtje: “10/1. Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës që shërbejnë në institucionet shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është si vijon:


Kualifikimi/Grada/Titulli shkencor Trajtimi financiar (Lekë në muaj) 1 Shef shërbimi Profesor, 75 000 2 Shef shërbimi Profesor i asociuar 70 000 3 Shef shërbimi Doktor i shkencave 67 000 10/2. Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë

i këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga fondet e miratuara për politikën e reja të pagave, në ligjin e buxhetit për vitin 2021. 4. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, në lidhjen II/4, emërtesat “Ndihmësmjek” dhe “Infermier” shfuqizohen.

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.



Në Ministrinë e Mbrojtjes me protokollin shtetëror dhe ceremoni më të lartë ushtarake, më 24 dhjetor 2020, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni priti në vizitë zyrtare, homologun e tij, ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Italisë, Lorenzo Guerini me delegacionin e tij të lartë ministror, diplomatik dhe ushtarak. Në takim bilateral në mes dy delegacioneve respektive, ministri Quni, e falënderoi dhe i shprehu kënaqësinë e veçantë ministrit Guerini për vizitën e tij edhe pse në rrethana të veçanta të krijuara nga kriza e pandemisë duke e vlerësuar lartë vizitën përkatëse edhe për këtë arsye. Në fjalën e tij, ministri Quni, gjithashtu shprehu mirënjohjen e lartë për Republikën e Italisë, si vend mik, në mbështetjen e ofruar në të gjitha periudhat e vështira në të cilat ka kaluar vendi dhe populli i Kosovës në të gjitha fushat. Ai nënvizoi përkrahjen e madhe gjatë dhe pas luftës, në ndërtimin dhe arritjet e deritashme të vendit e posaçërisht Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Në vazhdim, ministri Quni shprehu mirënjohjen e lartë për rolin dhe kontributin e madh në sigurinë e përgjithshme të vendit dhe rajonit të kontingjentit ushtarak italian në kuadër të KFOR-it të udhëhequr me sukses nga gjeneralët e shumtë italian duke theksuar edhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me ish-komandantin e KFOR-it, gjeneral Risin të pasuar me të njëjtin bashkëpunim edhe me komandantin



Ministri i Mbrojtjes Anton Quni priti homologun Italian, Lorenzo Guerini

Italia do të mbështesë perspektivën euro-atlantike të Kosovës

Ministri Quni: Mirënjohje për ushtarakët italian në cilësi të këshilltarëve bilateral dhe atyre në kuadër të Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s, që nga fillimi i ndërtimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së

aktual të KFOR-it gjeneralmajor Franco Federici. Ai theksoi edhe rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes të Italisë dhe Forcat e Armatosura të saj, duke pasur parasysh përvojën e madhe italiane në procesin e integritimeve euroatlantike dhe forcave ushtarake italiane në ngritjen dhe zhvillimin e operacionalitetit ushtarak në përgjithësi. Në vazhdim, ministri Quni shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë të ushtarakëve italian në cilësi të këshilltarëve bilateral dhe atyre në kuadër të Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s, që nga fillimi i ndërtimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Eksperiencën e tyre, ai e vlerësoi shumë të rëndësishme duke pasur parasysh fokusin në ngritjen e forcave të ndërveprueshme për

pjesëmarrje cilësore në operacione paqeruajtëse. "Pjesëmarrja në operacionet e paqes është ndër detyrat kryesore ligjore të FSK-së, andaj edhe synim ynë është zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat italiane dhe forcat tjera të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s. Ky synim do të kurorëzohet me ofrimin e mundësisë për ofrimin e kontributit tonë në kuadër të forcave shumëkombëshe për paqen, stabilitetin dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë"-tha ndër të tjera ministri Quni.

Nga ana e tij, ministri Guerini, falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe ndjenjën e veçantë të vizitës në prag të Krishtlindjeve në një vend mik. Ai përgëzoi ministrin Quni, për të gjitha të arriturat e deritashme të ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së duke konfirmuar angazhimin e

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni priti sot në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneral major Franco Federici. Duke falenderuar për mikpritjen, gjeneral Federici shprehu kënaqësinë e tij për arritjet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, profesionalizmin e lartë të dëshmuar deri më tani si dhe nivelin e lartë të bashkëpunimit në mes të KFOR-it dhe FSK-së. Ndër të tjera, ai shprehu gatishmërinë e plotë për vazhdimin e këtij bashkëpunimi dhe nivelit të marrëdhënieve të kultivuara nga paraardhësit e tij me qëllimin e përbashkët nën moton " Të bëjmë progres së bashku si një i vetëm".

Nga ana e tij, ministri Quni duke e uruar për detyrën e re, shprehu falenderimin dhe mirënjohjen e lartë për misionin e KFOR-it në shërbim të sigurisë së vendit dhe ndikimit të tij të madh edhe në sigurinë rajonale. Ai siguroi gjeneralin Federici se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK janë ndër-tuar dhe zhvillohen në konsistencë të plotë me normat, vlerat, parimet dhe standardet më bashkëkohore të vendeve të NATO-s si institucione nën kontrollin civil demokratik, me transparencë dhe llogaridhënie të plotë, si dhe forca me aftësi dhe kapacitete mbrojtëse në shërbim të

MINISTRI QUNI PRITI KOMANDANTIN E RI TË KFOR-IT

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, zhvillohen sipas standardeve të NATO-s

Marrëdhëniet midis KFOR-it dhe FSK-së konfirmojnë profesionalizëm dhe nivel të lartë bashkëpunimi



gjithë qytetarëve pa dallim. "Këto parime, vlera dhe standarde janë ndër-tuar dhe zhvillohen që nga fillimi nën mentorimin e NATO-s përmes Ekipi Këshillëdhënës të NATO-s, bashkëpunimit bilateral me vendet partnere dhe bashkëpunimit profesional dhe institucional me KFOR-in",- tha ndër të tjera ai.

Në fund të dy u pajtuan për inten-

sifikimin e bashkëpunimit, kontakteve dhe koordinimit të ndërsjellë për shkëmbimin e pikëpamjeve për çështjet me interes të përbashkët në kuadër të rolit dhe përgjegjësiive institucionale. Në shenjë të respektit të ndërsjellë, ministri Quni dhe gjeneral Federici mbyllën takimin me shkëmbimin e dhuratave.

Republikës së Italisë në paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon përmes KFOR-it. Ai në vazhdim shprehu interesimin e tij për shtimin e dinamikës për implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar para dy viteve në mes dy ministrive dhe shprehu zotimin e tij për angazhimin dhe përkushtimin maksimal për të mbështetur vizionin e lidershit të Ministrisë dhe FSK-së në planin politik, diplomatik dhe atë ushtarak për të ardhmen. "U siguroj se Republika e Italisë do të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive perspektivën euro-atlantike të Kosovës duke theksuar se do të intensifikohen marrëdhëniet dhe bashkëpunimi bilateral në funksion të interesave tona të përbashkëta",- tha ndër të tjera, ministri Guerini. Në vazhdim të diskutimeve, dy ministrat u pajtuan që ndër

hapat e parë të viti të ardhshëm të jenë vizitat e ndërsjella të dy shefave të mbrojtjes, respektivisht gjeneral Ramës dhe gjeneral Vecciarelli, për të konkretizuar aktivitetet bashkëpunuese bilaterale.

Në fund, të dy ministrat shkëmbyen mesazhet e urimit për festën e Krishtlindjeve me lutjet dhe dëshirat për vit më të mbarë për qytetarët, stafet e ministrive e forcave respektive me falënderimet e urimet e veçanta për ushtarakët italian dhe të gjithë ushtarakëve tjerë të KFOR-it me shërbim në Kosovë. Gjatë vizitës, ministri Guerini shoqërohej nga delegacioni në përbërje prej: shefit të Mbrojtjes së Italisë, gjeneral Enzo Vecciarelli, shefit të Shtabit të Operacioneve të Përbashkëta, vice admiral Pier Federico Bisconti, komandantit të KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici, ambasadorit të

Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, zëvendës shefit të Kabinetit për Politikën Ushtarake, admiralit Gianfranco Annunziata, atashut të Mbrojtjes i Italisë në Kosovë, kolonel Giuseppe Montalto, dhe këshilltarit diplomatik i ministrit, Massimo Marotti. Në anën tjetër, delegacioni i ministrit Quni përbëhej nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarja e përgjithshme, Rozafë Ukimeraj, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi, shefi i kabinetit të tij, Jashar Ramadani, këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Hamdi Pollomi, drejtori i departamentit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha dhe zyrtarja e lartë e kabinetit, Martina Dedaj-Kqira.



Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë, u realizua Stërvitja Fushore katërditore “Ujku vigjilent-02” me demonstrimin stërvitor përmbyllës të Kompanisë së Mekanizuar të Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore të FSK-së. Për të parë nga afër demonstrimin e operacioneve stërvitore, ishin ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj dhe atasheu ushtarak i SHBA-së, major Bret Wisecup. Ata u pritën nga zëvendëskomandanti i Regjimentit të Tretë, major Ilir Beqiri, dhe komandanti i Kompanisë së Mekanizuar, toger Bardhyl Dugolli, të cilët njoftuan lidhur me konceptin, njësitë e angazhuara, përbërjen e tyre, organizimin, skenarët si dhe kurset e veprimit të cilat u ekzekutuan në stërvitjen përkatëse.

Pas demonstrimit stërvitor, pjesëtarëve të task-forcës pjesëmarrëse në stërvitje iu drejtua ministri i Mbrojtjes, Anton Quni i cili shprehu impresionet e tij për nivelin e lartë të profesionalizimit të demonstruar gjatë stërvitjes. “Ky nivel profesional, kjo shkallë e angazhimit dhe përkushtimit janë faktori determinues i besimit të plotë në ju. Kërcënimet ndaj nesh fare nuk na brengosin, sepse fitues është ai që mbron vendin e vet”, - tha ndër të tjera ministri Quni.

Nga ana e tij, gjeneral Rama shprehu vlerësimin e lartë për



Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë

Zhvillohet stërvitja fushore katërditore “Ujku vigjilent-02”

Stërvitja fushore “Ujku vigjilent-02” shënon edhe përfundimin e ciklit të trajnimit tremujor me mbështetjen e AIR MEDEVAC të Ushtrisë Amerikane

shkallën e profesionalizimit të demonstruar duke theksuar se kjo e arritur me standardet bashkëkohore na forcon besimin në qëllimit tonë, integrimin në NATO me forca të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta me forcat aleate. “Sa më parë të realizojmë këtë qëllim do të jetë më mirë jo vetëm për vendit tonë, por edhe rajonin e më gjerë”, - tha ndër të tjera gjeneral Rama. Pas demonstrimit të operacioneve urbane, nga ana e ministrit Quni dhe gjeneral Ramës, u përrua solemnisht, Poligoni i Stërvitjeve për Operacione Urbane të FSK-së. Poligoni përkatës i përruar sot ka filluar së ndër-

tuari para një viti dhe plotëson të gjitha kushtet për trajnim deri në nivel kompanie. Ky moment ishte shumë domethënës pasi që ideator për ndërtimin e këtij poligoni ishte nënoficeri i dalluar i FSK-së, tashmë i ndjerë, kapter Baki Ejupi. Stërvitja fushore “Ujku vigjilent” shënon edhe përfundimin e ciklit të trajnimit tremujor të kompanisë përkatëse me mbështetjen edhe të AIR MEDEVAC të Ushtrisë Amerikane. Ky është aktiviteti i radhës i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të procesit të zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen e territorit, si detyrim kryesor ligjor i saj.

FSK-së arriti sukses në stërvitjen ndërkombëtare “Cambrian Patrol”

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni priti në takim lamtumirës atasheun e mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, nënkolonel Andrew Layton. Me këtë rast, nënkolonel Layton shprehu impresionet e tij të përgjithshme për vendin dhe shoqërinë tonë si dhe impresionet e veçanta për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në dhe të arriturat e tyre të deritashme. Ai theksoi se shkalla profesionale dhe operacionale e FSK-së për një kohë kaq të shkurtër është unike duke e ilustruar me sukseset e ekipeve të FSK-së edhe në stërvitjen e famshme ushtarake ndërkombëtare vjetore “Cambrian Patrol” dhe eksperiencën e tij si pjesëmarrës i ekipit britanik duke theksuar se për suksese të ngjashme si të FSK-së duhej kohë e gjatë.

Në vazhdim ai prezantoi edhe



pasardhësin e tij, nënkolonel Matthew Walker. Nga ana e tij, ministri Quni shprehu falenderimin, mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për angazhimin dhe përkushtimin e nënkolonel Layton si dhe kontributin e tij në thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes si dhe marrëdhënieve bilaterale me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar. Ai gjithashtu i uroi detyrën e atasheut të ri të mbrojtjes për Kosovë, duke shprehur gatishmërinë

për vazhdimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të përbashkët si dhe besimin, që marrëdhëniet bilaterale të intensifikohen edhe më tej në të ardhmen në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Në fund, ministri Quni, në shenjë të mirënjohjes për shërbim të shquar dhe të merituar si dhe përmëshje të detyrës me përgjegjësi të lartë, nënkolonelit Layton i dhuroi paketën me logon e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.

MINISTRI I MBROJTJES ANTON QUNI

Kadetët e FSK-së arsimohen në akademitë më të njohura në botë

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, me ftesë të kolegjit “Universum” në cilësinë e ligjëruesit, para studentëve të nivelit bachelor dhe master mbajti një ligjëratë të titulluar “Siguria dhe mbrojtja”. Ministri në ligjëratën e tij ishte i fokusuar në problemet dhe çështjet e sigurisë të nivelit global, regjional dhe vendor. Gjatë ligjëratës ministri Quni u fokusua edhe në procesin e transformimit të FSK-së, bashkëpunimit me NATO-n, partnerët strategjik, bashkëpunimet dy paleshe dhe trajnimet jashtë vendit. Duke qenë në mjedis akademik, ai

Kadetët e FSK-së kanë treguar suksese shumë të larta në akademitë ushtarake “West Point” në SHBA dhe “Sundhurst” në Angli

foli edhe për shkollimin e kadetëve të FSK-së në akademitë më të njohura në botë, si ajo, “West Point” në SHBA dhe “Sundhurst” në Angli, ku kadetët e FSK-së kanë treguar suksese shumë të larta. Ai po ashtu ka fol edhe për çështje tjera me rëndësi, si për procesin në të cilin gjendet FSK-ja dhe rrethanat e sigurisë, që kanë të bëjnë me shtetin e Kosovës. Ligjëratë është mbajtur në formë bashkëbisedimi në mes të ministrit dhe stu-

dentëve. Interesimi i studentëve ishte i madh rreth çështjeve të sigurisë, posaçërisht krijimit të FSK-së dhe misionit të ri të saj, misionin mbrojtës. Numri i studentëve ishte i madh dhe po ashtu edhe interesimi për t'i shtruar pyetje ministrit Quni. Në fund studentët panë një video dokumentar nga ushtrimi fushor i FSK-së “Shqiponja 6”, të cilëve pjesa praktike ushtarake u dha emocion të veçantë.

Viti 2020 është historik, për shkak të anëtarësimit në NATO

Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komandanti Suprem i Armatës, Stevo Pendarovski, u informua në Shtëpinë e Armatës në Shkup, nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral-nënkolonel Vasko Gjurçinovski mbi gjendjen dhe gatishmërinë luftarake të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2020. Në informimi e parë për gatishmërinë luftarake pas anëtarësimit të plotë në NATO mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, gjeneralët në Armatë dhe përfaqësues të kabinetit të Presidentit dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë konferencës, Presidenti Pendarovski u informua për gjendjen në Armatë sipas fushave funksionale në vijim: moralin dhe menaxhimin me personelin, operacionet, trajnimet dhe stërvitjet, logjistikën, planifikimin, komunikimin, buxhetimin dhe bashkëpunimin civilo-ushtarak. Më pas u theksuan aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara në lidhje me trajnimin, angazhimin e Armatës në ndihmë të institucioneve në trajtimin e "Covid-19", rrjedhën e proceseve të transformimit dhe integritet që ndodhin në përputhje me standardet e NATO-s dhe segmente të tjera të punës së njësisë, që kanë ndikim në gatishmërinë luftarake.

Nga gjenerali Gjurçinovski u theksua se me angazhim të veçantë dhe profesionalizëm të gjithë pjesëtarëve të Armatës, realizohen të gjitha detyrat e caktuara në mbështetje të institucioneve që përballen me krizën epidemiologjike të shkaktuar nga virusi Covid-19, me sukses janë duke u realizuar përgatitjet dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare dhe se përmbushja e të gjitha detyrave të planifikuara në lidhje me integrimin e plotë në strukturën e NATO-s do të vazhdojë me një ritëm të njëjtë. Po ashtu, u theksua rritja e gatishmërisë luftarake në vitin aktual, veçanërisht në fushën e moralit të pjesëtarëve të Armatës bazuar në përmirësimin e standardeve të



Ministrja Shekerinska: "Niveli i lartë i gatishmërisë luftarake demonstrohet çdo ditë nga paqeruajtësit tanë të angazhuar në operacionet për mbështetje të paqes"



jetesës dhe kushteve të jetesës dhe punës duke rinovuar objektet në kazermat.

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska tha se si një anëtare e NATO-s, Maqedonia e Veriut ka një detyrim jo vetëm për të arritur, por edhe për të avancuar standardet e NATO-s në hap me aleatët, që do të thotë investim i vazhdueshëm në gatishmërinë luftarake të Armatës. Ajo theksoi se përparësia është investimi në potencialin njerëzor, fluksin e ushtarëve të rinj motivimi i të cilëve u nxit nga kushtet e përmirësuar, pagat më të larta dhe modernizimi i Armatës. Rritja e vazhdueshme e buxhetit të mbrojtjes me 0.2% në 3 vitet e fundit, në mënyrë që të arrihet 2% e PBV-së deri në vitin 2024 ka mundësuar këtë, tha ministrja. "Forcimi i gatishmërisë luftarake të Armatës është prioriteti i yni kombëtar dhe i NATO-s. Batalioni i Këmbërorisë së Lehtë do të rritet në një Grup Luftarak të Këmbërorisë së Lehtë për disa vjet. Fokus i kryesor në ndërtimin e kësaj aftësie të NATO-s është personeli, pajisjet dhe trajnimi. "Niveli i lartë i gatishmërisë luftarake demonstrohet çdo ditë nga paqeruajtësit tanë të angazhuar në operacionet për mbështetje të paqes", - tha ministrja Shekerinska.

Presidenti dhe Komandanti Suprem, Stevo Pendarovski në fjalimin e tij drejtuar pjesëmarrësve në konferencën për shtyp tha: "Viti i kaluar 2020, me të gjitha sfidat që na ka sjellë, është historik për Armatën, për shkak të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, një akt që përmbushi një nga qëllimet tona kryesore strategjike si shtet, dhe vlerësoi përpjekjet e përgjithshme të pjesëtarëve të mbrojtjes që nga pavarësia e deri më sot. Si Komandant Suprem, unë jam krenar për profesionalizmin dhe angazhimin e lartë të treguar nga pjesëtarët e Armatës edhe vitin e kaluar. Situata e deklaruar e krizës edhe një herë konfirmoi gatishmërinë e Armatës për t'iu përgjigjur shpejt nevojave të institucioneve dhe për të ofruar mbështetje kur është e nevojshme. Investimet në modernizimin dhe pajisimin e Armatës duhet të vazhdojnë. Një nga përparësitë e mia kryesore mbetet në vitet e ardhshme për të arritur qëllimin e caktuar, 2% e PBV-së të alokohet për mbrojtjen." Informimi mbi gatishmërinë luftarake është një detyrim vjetor i planifikuar i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ndaj Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura.

Sipas Planit të Punës së Shtabit të Përgjithshëm, para Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë maqedonase, Gjenerallejtënant Vasko Gjurcinovski, u paraqit raporti vjetor për statusin e komandave dhe njërive vartëse për vitin aktual 2020. Komandantët e komandave dhe njërive vartëse i prezantuan para Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë maqedonase, Gjenerallejtënant Vasko Gjurcinovski, aktivitetet e realizuara, fushëveprimin e stërvitjes, nivelin e pajisjeve në njësi dhe ndikimin e tyre në gatishmërinë luftarake. Ata gjithashtu e informuan atë për situatën në njësitë e tyre në drejtim të menaxhimit të personelit, mbrojtjes së forcës, operacioneve, trajnimeve dhe stërvitjeve, logjistikës, komunikimeve, buxhetimit dhe bashkëpunimit civil-ushtarak.

Janë prezantuar realizimi i detyrave të planifikuara, rezultatet e arritura në drejtim të arritjes së standardeve të NATO-s, aktivitetet aktuale në kryerjen e trajnimit si dhe

Sfida për vitin 2021: Integrim i plotë në strukturat e NATO-s

Paraqitet raporti vjetor për statusin e komandave dhe njërive vartëse për vitin 2020 dhe objektivat për vitin 2021



angazhimet për të ndihmuar institucionet në parandalimin e përhapjes së Covid-19, kushtet e jetesës dhe punës në garnizone dhe mësimet e marra.

Në fund të raportit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjener-

allejtënant Vasko Gjurcinovski, së bashku me konkluzionet mbi situatën aktuale, paraqitën udhëzimet për aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm 2021, kryesisht në lidhje me detyrimet për integrim të plotë në strukturat e NATO-s.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjenerallejtënant Vasko Gjurcinovski vizitoi kandidatët të cilët janë në trajnim profesional dhe përmirësimin e kursit bazë për nënoficerë, i cili është realizuar në Qendrën e Trajnimit Pepelishte dhe poligonin ushtarak Krivolak. Gjatë turneut në grupin e parë të anëtarëve të Ushtrisë, i cili po kalon trajnim profesional dhe i cili pas kursit do të marrë një gradë nënoficer, gjenerali Gjurcinovski inspektoi fushën dhe mënyrën e realizimit të trajnimit, që është në kompetencën e Komandës së Trajnimit dhe doktrinave. Duke iu drejtuar audiencës së kandidatëve për nënoficerë, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm së pari i informoi ata për përfshirjen aktuale të Ushtrisë në ndihmën e institucioneve në trajtimin e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, pas së cilës



ai theksoi rëndësinë e nënoficerëve në zinxhirin e komandës së Ushtrisë. Në procesin e trajnimit ku ata do të jenë bartësit kryesorë, si në të gjitha ushtritë e vendeve anëtare të NATO-s. Ai theksoi se kunji dhe aspirata për të marrë gradën e nëno-

ficerit të kësaj gjenerate të parë nënoficerë, pas anëtarësimit tonë të plotë në NATO, fiton një rëndësi edhe më të madhe sepse ata do të jenë nënoficerët e parë të NATO-s në kuptimin e vërtetë, sepse taktikat, teknikat dhe procedurat e trajnimit janë në përputhje me të gjitha standardet e NATO-s. Kursi aktual për nënoficerë është i pari nga dy, që do të realizohen dhe në të marrin pjesë 60 kandidatë për nënoficerë, të cilët zgjidhen nga të gjitha njësitë e Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, në përputhje me rregulloren për pranimin e kandidatëve për oficerë dhe nënoficerë, në një njoftim të brendshëm në Ushtri.

Stoltenberg: Mali i Zi mbetet besnik dhe aleat i përkushtuar i NATO-s

Zdravko Krivokapiç: “Nëse bëhet fjalë për të hyrë në konflikt me ndonjë politikë të aleancës, ne do të pajtohemi me politikën e aleancës në çdo rast, që është një përgjigje shumë e qartë për rrugën që do të marrë Mali i Zi”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg priti Kryeministrin e Malit të Zi Zdravko Krivokapiç, në Selinë e NATO-s në Bruksel, ditën e martë, më 15 dhjetor 2020. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg falenderoi Malin e Zi për angazhimin e tij për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe kontributet e tij në misionet dhe operacionet e NATO-s. Të dy udhëheqësit diskutuan solidaritetin e Aleancës në luftimin e pandemisë COVID-19, sfidat aktuale të sigurisë dhe mënyrën se si NATO-2030 do të forcojë më tej Aleancën.

Pas takimit zyrtar, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në deklarinë e përbashkët për shtyp me Kryeministrin e Malit të Zi, Zdravko Krivokapiç, ka uruar këtë të fundit për emërimin si Kryeministër i Malit të Zi. “Unë dua t’ju falenderoj për angazhimin tuaj të fortë për integrimin Euro-Atlantik dhe reformat”, - tha Jens Stoltenberg. Ai u shpreh se: “Mali i Zi është një Aleat i vlerësuar, duke dhënë kontribute të rëndësishme për sigurinë tonë të përbashkët. Ju siguron mbështetje financiare për Forcat e Sigurisë Afgane. Ju gjithashtu kontribuoni në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë. Ndërtimin dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Mirëpres, që Mali i Zi po rrit shpenzimet e mbrojtjes. Të gjitha këto kontribute e mbajnë të fortë NATO-n”.

Duke ju drejtuar kryeministrit të Malit të Zi, Zdravko Krivokapiç, Jens Stoltenberg tha se: “Pandemia COVID-19 vazhdon të na sfidojë të gjithëve, por Mali i Zi nuk qëndron vetëm. Qendra e ndihmës ndaj katastrofave të NATO-s ka koordinuar ndihmën për Malin e Zi dhe Aleatët kanë shpërndarë furnizime të domosdoshme mjekësore. Vetëm muajin e kaluar, Mali i Zi mori ndihmë përfshinte 20 ventilator nga rezervat e reja mjekësore të NATO-s. Ndërkohë furnizime shtesë me vlerë 500.000 euro janë në rrugën e tyre për në Malin e Zi. Ky është solidariteti i NATO-s në veprim”.

Duke u ndalur ne sfidat e sigurisë, z. Stoltenberg tha se: “në të njëjtën kohë, sfidat e sigurisë me të cilat u përballëm para pandemisë nuk janë zhdukur. Kështu që misioni i policisë



ajrore të NATO-s vazhdon, për të garantuar sigurinë e qiellit tuaj, me avionë nga Italia dhe nga Greqia. Unë përgëzoi Malin e Zi për promovimin e stabilitetit në rajon. NATO mbetet e përkushtuar ndaj Ballkanit Perëndimor, është thelbësore për stabilitetin e Evropës. Ne gjithashtu diskutuam NATO-2030 dhe përpjekjet tona për ta bërë këtë Aleancë edhe më të fortë. Ne duhet të sigurohemi, që të qëndrojmë të fortë ushtarakisht, të bëhemi më të fortë politikisht dhe të marrim një qasje më globale ndaj sfidave me të cilat përballemi. Unë pres që të punoj me ju dhe t’ju mirëpres në Samitin e NATO-s këtu në Bruksel vitin e ardhshëm”.

Pyetje, Ivan Mijanović, Radio dhe Televizioni i Malit të Zi: Qeveria e re malazeze njoftoi përmirësimin e marrëdhënieve me Rusinë, a mendoni se përforsimi i bashkëpunimit me Moskën mund të shkojë paralelisht me politikën e Aleancës dhe një pyetje për Kryeministrin Krivokapiç: Cilat janë përshtypjet tuaja, pas vizitës së parë në NATO dhe vizitës tek Sekretari i Përgjithshëm? A do të vazhdojë Mali i Zi të përbushë detyrimet nga anëtarësimi në NATO, si për shembull stërvitjet?

Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg:

Ne besojmë në dialog, ne sigurojmë një mbrojtje kritike për të gjithë aleatët, por në të njëjtën kohë jemi në gjendje të përfshihemi në dialog me Rusinë, për një marrëdhënie më të mirë. Rusia nuk është një aleate. Ne kemi parë, që Rusia është përpjekur të përzihet në politikën e brendshme në proceset demokratike në disa vende aleate të NATO-s. Ne i

kemi parë ata të jenë përgjegjës për sulmet kibernetike kundër institucioneve tona demokratike dhe kemi parë Rusinë të gatshme të përdorë forcën ushtarake kundër fqinjëve. Për shembull, ata kanë aneksuar në mënyrë të paligjshme Krimenë. Pra, ne duhet të ndjekim këtë qasje të dyfishtë. Frenim kritik, mbrojtje, por në të njëjtën kohë dialog dhe përmes kësaj të përpikemi të përmirësojmë marrëdhëniet me Rusinë, por Rusia duhet të respektojë të drejtën ndërkombëtare, të respektojë integritetin territorial dhe sovranitetin e të gjitha vendeve në Evropë.

Kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiç

Më lejoni të rifilloj dhe t’i përgjigjem pyetjes së parë. Padyshim, në fjalën time përuuese, të cilën unë prezantova në Parlamentin e Malit të Zi, unë u bëra të gjithëve të ditur se ne do të forcojmë të gjitha marrëdhëniet e mira me të gjithë, përfshirë Rusinë. Kjo pjesë ishte e lidhur vetëm dhe vetëm me aktivitetet e nevojshme ekonomike dhe turizmin, sepse fluksi më i madh i turistëve në Mal të Zi vjen nga Rusia. Dhe kur bëhet fjalë për të hyrë në konflikt me ndonjë politikë të aleancës natyrisht ne do të pajtohemi me politikën e aleancës në çdo rast të tillë që është një përgjigje shumë e qartë për rrugën që do të marrë Mali i Zi. Kur bëhet fjalë për këtë pyetje të dytë, unë pjesërisht u përgjigja, duke folur për misionet, kështu që, nuk ka nevojë që unë të përsëris veten. Por kur bëhet fjalë për fushat e stërvitjes, pyetja juaj ndoshta ka të bëjë me situatën që ka ndodhur në malin Sinjajevina dhe ne do të analizojmë me kujdesin e duhur të gjitha mundësitë dhe do të gjejmë një terren të mirë trajnimi, që

do të plotësojë standardet e NATO-s. Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm për gjithçka që po bëjmë, duhet të gjejmë zgjidhjen më të mirë në mënyrë që të plotësojmë nevojat e kërkesave të NATO-s dhe planet tona dhe të ruajmë vlerën thelbësore, që është para së gjithash mjedisi ynë.

Pyetje, Jovana Djuricic, "Pobeda": Zoti Sekretar i Përgjithshëm, a prisni që qeveria e re malazeze do të ketë një angazhim të plotë për anëtarësimin në NATO dhe a morët një konfirmim të tillë nga Kryeministri duke pasur parasysh se bashkëpunëtorët e tij të ngushtë dhe anëtarët e kabinetit të tij ishin kundërshtarët e mëdhenj të anëtarësimit në NATO, gjë që u demonstrua duke djegur flamurin e NATO-s. Dhe një pyetje më shumë për Kryeministrin, a do të ndryshojë ky vendim për alokimin e 2% të planifikuar për mbrojtje? Ky vendim u mor nga qeveria e mëparshme. A do të rishikohet kjo duke pasur parasysh edhe situatën me coronavirusin?

Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg:

Mali i Zi do të mbetet besnik dhe aleat i përkushtuar i NATO-s, ky ka qenë mesazhi i qartë nga Kryeministri. Është një angazhim për të rritur më tej përpjekjet për modernizimin e forcave të armatosura të Malit të Zi dhe gjithashtu përsëritjen e faktit, që për shembull NATO siguron policinë ajrore për Malin e Zi. Dhe gjithashtu mendoj se duhet të kuptoni që anëtarësimi i Malit të Zi në NATO është i mirë për Malin e Zi, është mirë për NATO-n, është mirë për të gjithë rajonin. Dhe ajo që kemi parë është se NATO është aleanca më e suksesshme në histori, sepse ne kemi qenë në gjendje të ruajmë paqen. Qëllimi ynë nuk është të provokojmë një konflikt, por qëllimi ynë është të ruajmë paqen dhe stabilitetin është një parakusht për prosperitetin ekonomik. Ne kemi parë, që në të gjithë Evropën, çdo herë që NATO fton një anëtar të ri në aleancën tonë është mirë për sigurinë, por është gjithashtu e mirë për prosperitetin ekonomik. Pra, është në interes të Malit të Zi, është në interesin e të gjithë aleatëve të NATO-s, që të qëndrojmë së bashku. Kur qëndrojmë së bashku, ne jemi më të sigurt dhe ruajmë paqen dhe ky ishte mesazhi i qartë nga Kryeministri, që Mali i Zi do të vazhdojë të jetë një aleat i përkushtuar i NATO-s.

Kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapić

Për të mos qenë në kundërshtim, unë do të doja të shprehja një mendim shumë të qartë. Isha profesor dhe pendohem, nëse ndonjë djege e flamurit ka ndodhur në Malin e Zi, unë nuk e kam marrë parasysh atë për shkak të profesionit tim, unë kam qenë duke u marrë me profesionin tim. Pra, ajo që

thatë i referohet vetëm një personi dhe unë dua të them se ai zotëria në fjalë dha një deklaratë duke specifikuar qartë se ai mbështet marrëveshjen, që koalicioni kishte nënshkruar menjëherë pas zgjedhjeve. Më lejoni të them dhe kjo është diçka që Sekretari i Përgjithshëm e ka thënë tashmë, të gjithë ne evoluojmë, ne ndryshojmë, kështu që lejoni që kjo të ndryshojë në mënyrë që të gjithë së bashku të jemi partnerë që do të vlerësojmë njëri-tjetrin, duke respektuar njëri-tjetrin dhe së bashku.

Pyetje, Maria Psara nga "Open TV" Greece: Zoti Sekretar i Përgjithshëm, ju keni shprehur shqetësime në lidhje me prokurimin dhe testimin e S-400 nga Turqia dhe SHBA-ja ka vendosur sanksione kundër Turqisë. Unë do të doja ta komentoja atë. Dhe ju lutem komentoni përsëri mbi rezultatet e Këshillit Evropian për Turqinë?

Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg:

Më vjen keq që jemi në një situatë ku aleatët e NATO-s duhet të vendosin sanksione ndaj njëri-tjetrit. Dhe unë gjithashtu kam shprehur shqetësimet e mia në lidhje me pasojat e vendimit turk për të blerë sistemin rus S-400 të mbrojtjes ajrore dhe raketore. Ky është një vendim kombëtar, por sistemi S-400 nuk është i pajtueshëm me sistemet e NATO-s, ai nuk mund të integrohet në mbrojtjen e integruar ajrore dhe raketore të NATO-s dhe për këtë arsye unë kam shprehur shqetësimet e mia për këtë edhe më parë. Në të njëjtën kohë, unë i nxis të gjithë aleatët e NATO-s dhe Turqinë dhe aleatët e tjerë të shikojnë nëse ka mënyra për të gjetur një zgjidhje pozitive. Ne e dimë që ka pasur bisedime më parë për mundësinë e shpërndarjes së sistemeve të NATO-s, si për shembull sistemi "Patriot" ose "SAMP-T" që janë sisteme të NATO-s, që mund të forcojnë, të rrisin mbrojtjen ajrore turke, por gjithashtu ta bëjnë atë në një mënyrë, që është e përputhshme dhe e mundur për t'u integruar në mbrojtjen ajrore dhe raketore të NATO-s, kështu që mendoj se është e rëndësishme që të gjithë tani të shikojmë se si mund të gjejmë një zgjidhje pozitive të kësaj situatë të vështirë për Turqinë dhe aleancën.

Pyetje, Marina Maksimovic, Agjencia e Lajmeve "Tanjug": Zoti Stoltenberg, meqenëse dëgjojmë shumë njerëz dhe politikanë nga vendet perëndimore që po thonë se, anëtarësimi në NATO i vendeve të Ballkanit Perëndimor është një garanci për paqen në rajon, a mendoni se ndoshta neutraliteti serb në këtë situatë mund të jetë një lloj rreziku për paqen dhe stabilitetin në rajon?

Zoti Kryeministër Krivokapić. Ju folët për një rrugë paralele drejt BE-së dhe NATO-s. A mendoni se tani,

në këtë moment kur të gjitha vendet janë në këtë ngërç kur bëhet fjalë për zgjerimin, a ju mundëson anëtarësimi në NATO për një hyrje më të shpejtë në BE?

Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg:

Nëse një vend dëshiron të anëtarësohet në NATO sigurisht, që ne ulemi dhe diskutojmë dhe vlerësojmë nëse ato përmbushin standardet e NATO-s. Kjo është pikërisht ajo që bëme me Malin e Zi, ata i plotësuan standardet e NATO-s dhe ne e ftuam Malin e Zi. Ky është gjithashtu rasti me Maqedoninë e Veriut, anëtar i ynë më i ri, ata vendosëm të aplikojmë dhe ne vlerësuam se ata i plotësonin standardet e NATO-s, ne i ftuam dhe tani ata janë anëtar i ynë më i ri. Në të njëjtën kohë, ne natyrisht i respektojmë vendimet e Serbisë për të mos aplikuar për anëtarësim dhe ne respektojmë neutralitetin e Serbisë, ky është vendimi i tyre. Dhe nuk ka asnjë mënyrë, që NATO të përpriqet ta ndryshojë atë vendim, ai është një vendim sovran serb të cilin ne e respektojmë plotësisht. Ne e mirëpresim, që Serbia është një partner i ngushtë i NATO-s, që ne punojmë së bashku me Serbinë për çështje të ndryshme. Për shembull, kemi pasur një stërvitje të madhe për lehtësimin e fatkeqësive atje, jo shumë vite më parë kemi punuar me ta. Gjithashtu në zona të tjera do të vazhdojnë të punojnë me Serbinë si një partner i ngushtë duke respektuar plotësisht sovranitetin e tyre dhe faktin që ata nuk duan të jenë anëtarë të ndonjë aleance ushtarake. Kemi partnerë të tjerë të ngushtë si Finlanda dhe Suedia. Ata nuk janë anëtarë të NATO-s por ata janë partnerë shumë të ngushtë të NATO-s dhe unë e mirëpres faktin që ne jemi gjithashtu në gjendje të forcojmë më tej partneritetin tonë me Serbinë, duke respektuar plotësisht vendimin e tyre kombëtar sovran për të qenë një vend neutral.

Kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapić

Epo më lejoni të përgjigjem, pasi Sekretari i Përgjithshëm dha një përgjigje që përkon absolutisht me atë që unë mendoj. Më lejoni të kthehem përsëri tek ju, në dy pistat paralele që përmendët. Edhe pse duket se këto janë dy shtigje paralele në shikim të parë, çfarë është e sigurt dhe çfarë është demonstruar nga praktikat e deritanishme është që ne do të përfundojmë detyrimet tona që kanë të bëjnë me integrimin në BE, edhe nëse ky vend është një shtet anëtar i NATO-s. Dhe kjo është provuar në rastin e vendeve të tjera anëtare, kështu që unë besoj se kjo rrugë për të cilën Mali i Zi ka zgjedhur do të jetë më e shpejtë, më gjithëpërfshirëse, kështu që unë rekomandoj të gjithëve që të ndjekin të njëjtën rrugë.

Dezinformimi në Ballkanin Perëndimor dhe siguria rajonale

Përgatiti: MSC MIMOZA GOLIKJA

Rajoni i Ballkanit Perëndimor është shumë i prekshëm nga dezinformimi i huaj, i cili është intensifikuar në vitet e fundit. Pse ndodh kjo? Çfarë mund të bëhet për ta zbutur atë? Demonizimi i Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s; paraqitja e BE-së si e dobët dhe e ndarë; reklamimi i fuqisë ushtarake ruse dhe epërsia e vaksinave COVID-19 dhe pretendimi se prodhuesit e vaksinave perëndimore janë të korruptuar; apo amplifikimi i perceptimeve të kërcënimeve, miteve dhe tensioneve etnike, janë ndër temat më të shpeshta të dezinformimit të promovuara nga Kremli në mediat në gjuhën serbe në Ballkanin Perëndimor. Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia janë më të prekurit nga operacionet e informacionit rus që përpiqen të minojnë Bashkimin Evropian dhe NATO në rajon. “Në një kuptim më të gjerë, dezinformimi është një fenomen endemik në Ballkanin Perëndimor i shkaktuar nga faktorë të brendshëm. Pa përjashtim, të gjitha kombet në rajon janë prekur. Kur bëhet fjalë për dezinformimin e huaj, Serbia konsiderohet të jetë në epiqendër. Studimi i fundit i dezinformimit të Parlamentit Evropian e quajti atë një “shtyllë nisjeje për operacionet dezinformuese ruse në Ballkanin Perëndimor”, shkruan Daniel Sunter, në faqet e NATO-s. Ai është themeluesi i portalit të mbrojtjes dhe sigurisë, “Balkan Security Network”, i cili lidh redaktorët, analistët dhe gazetarët në rajon dhe promovon raportimin e bazuar në fakte. Ai është

Dezinformimi demonizon NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara, ushqen tensionet etnike dhe paraqet Bashkimin Evropian si një organizatë jofunksionale, raciste dhe antiserbe

Drejtor Ekzekutiv i Nismës Euro-Atlantike me bazë në Beograd, e cila punon në projekte komunikimi dhe analiza dezinformimi.

Fluksi i informacionit midis vendeve në rajon është pa kufij, thotë autori. Lidhjet e ngushta shoqërore, historike dhe kulturore midis Serbisë, entitetit serb boshnjak të Republika Srpska dhe Malit të Zi do të thotë që pothuajse të gjitha rrëfimet e medias, përfshirë dezinformimin, rrjedhin përtej kufijve çdo ditë. “Përmbajtja mediale e sponsorizuar nga Kremli prodhohet, ribotohet dhe shpërndahet gjerësisht në të gjithë rajonin. Ajo konsumohet nga miliona në shoqëritë me brishtësi të natyrshme dhe ndarje të brendshme, në një rajon që tradicionalisht ka një qëndrim pozitiv ndaj Rusisë dhe ku perceptimet ende ndikohen nga konfliktet etnike në vitet 1990 dhe Fushata Ajrore e Kosovës në NATO në Mars 1999. Ndryshe nga Lindja-krah vendeve anëtare të BE dhe NATO, rajonit i mungojnë përvojat historike negative me Moskën dhe ndan një fe të përbashkët Ortodokse”.

Përtej prezantimit idealist të udhëheqjes ruse dhe armëve të saj, një dezinformim i tillë demonizon NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara, ushqen tensionet etnike dhe paraqet Bashkimin Evropian si një organizatë jofunksionale, raciste dhe antiserbe. Ai amplifikon perceptimet e kërcënimeve të popullatës ortodokse, si dhe një kulturë

përkujtimi që portretizon Rusinë dhe Bashkimin Sovjetik si mbrojtës të fuqishëm gjatë gjithë historisë. Shfaqja e këtyre rrëfimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi përkon me aneksimin e paligjshëm të Krimesë në Mars 2014. Shërbimi i lajmeve Sputnik u lançua në gjuhën Serbe, në shkurt 2015. Dhjetra portale me dhe pa impresion (d.m.th. një deklaratë e autorizuar ligjërisht e pronësisë dhe e autorësisë) janë shfaqur, duke gjeneruar ose shpërndarë mesazhe të ngjashme.

Me kalimin e kohës, media të ndryshme, duke përfshirë mediat kryesore në vendet e prekura filluan të përdorin përmbajtje të dezinformimit të huaj në një shkallë të gjerë. Kjo u bë e mundur për shkak të një peisazhi mediatik të karakterizuar nga tabloidizimi, logjika e klikimit, standardet e dobëta etike, gazetaria hulumtuese dhe analiza e lajmeve dhe ndikimet politike.

Kërkimet nga Qendra për Kërkime, Transparencë dhe Llogaridhënie me qendër në Beograd nga 2018 dhe 2019 tregojnë se, nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë në sferën e informacionit në gjuhën serbe, Rusia paraqitet me përmbajtjen më pozitive dhe më pak negative. “Në praktikë, kjo do të thotë që konsumatori mesatar i medias mëson më shumë rreth avantazheve të supozuara të rezervuarit Armata, tubacionit Nord Stream 2, për Ukrainën si një shtet të

dështuar që tradhtoi mendjen e shëndoshë në distancimin nga Rusia, ose për raketat hipersonike ose luftarakët Su- 57, sesa në lidhje me përfitimet e anëtarësimit të mundshëm në BE për popullsinë e Ballkanit. Ndotja kronike e mjedisit të informacionit me këtë përmbajtje ndikon në perceptimet e publikut. Ndërsa sondazhet rajonale sugjerojnë se shumica e popullsisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi janë akoma në favor të integritimit në BE, kjo ndjenjë nuk duhet të merret si e mirëqenë. Mbështetja për Bashkimin Evropian është në rënie në Serbi, ku shumica ka një mendim të favorshëm për Rusinë dhe Kinën, dhe qëndrimet ndaj NATO-s po bëhen gjithnjë e më negative". Nga ana tjetër "Maqedonia e Veriut ishte një shembull i propagandës, veprimtarive diplomatike dhe të inteligjencës së bashkërenduar për gati dhjetë vjet para anëtarësimit të saj në NATO në vitin 2020. Aktivitetet e informacionit tani përqendrohen në paraqitjen e vendit si viktimë të shteteve të saj fqinje, Bullgarisë dhe Greqisë dhe, Qeveria përëndimore në Shkup të dorëzohet në kërkesat e Sofjes për çështjen e identitetit".

Pandemia rrit propagandën

Kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19 po forcon narrativat propagandistike të epërsisë dhe demonizimit të Perëndimit. Temat që lidhen si me shkencën ashtu edhe me mbrojtjen përdoren për këtë qëllim, të kombinuara me ndihmën ushtarake të pandemisë të quajtur "diplomacia e ventilimit" nga disa ekspertë. "Në mes të nëntorit, disa ditë pasi qeveria serbe njoftoi blerjen e 1.8 milion vaksinave të bëra nga Pfizer, prodhuesi amerikan i vaksinave u portretizua nga Sputnik Serbia pa prova si të korruptuara dhe "jo të plota", ndërsa vaksinat ruse u portretizua si superiore dhe si një zgjedhje më e mirë për Serbinë. Versione të ndryshme të historisë së epërsisë së vaksinave ruse u shpërndanë nga pikat në Serbi dhe Mal të Zi".

Gjatë valës së parë të pandemisë, aktivitetet dezinformuese u përpoqën të përdorin Serbinë dhe Republika Srpska për të ilustruar ndihmën efektive ruse në krahasim me paaftësinë e supozuar të NATO-s për të ndihmuar shtetin e saj anëtar Malin e Zi në kohë krize. Në prill të vitit 2020, me shumë shkëlqim mediatik, 11 avionë rusë me 87 mjekë ushtarakë, specialistë dhe pajisje kimike nukleare biologjike u ulën në Serbi për të dezinfektuar rrugët, spitalet dhe kazermat në të gjithë vendin. "Ndërsa Serbia ka kapacitetet e veta ushtarake për të njëjtat qëllime, këto u hodhën në hije nga mysafirët. Imazhi i prodhuar nga media i ndihmës së huaj "thelbësore" kishte një ndikim

të rëndësishëm në dialogun publik. Një aktivitet i ngjashëm u krye në Republika Srpska. Nga ana tjetër, dezinformimi vazhdoi ta portretizojë Malin e Zi si një vend të braktisur nga aleatët e saj në mes të krizës, ndërsa ishte i detyruar të shpenzonte para për anëtarësimin në NATO në vend që të përmirësonte sistemin e tij të kujdesit shëndetësor. Në të njëjtën kohë, u shfaqën teori ekzotike konspirative të mbështetura nga gjeneralët rusë: se pandemia nuk është e vërtetë dhe është më tepër pjesë e një operacioni të posaçëm nga qendrat sekrete të pushtetit dhe se COVID-19 u prodhuar në të vërtetë nga CIA". Ushtrimi Mbrojtës i Evropës 20 i udhëhequr nga SHBA shërbeu gjithashtu si një mjet për teoritë e mëtejshme të konspiracionit si pjesë e narrativës së dezinformimit COVID-19, duke demonizuar si Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n. "Paralelisht, u krijua përmbajtje për të theksuar fuq-



inë dhe epërsinë ushtarake të Rusisë ndaj Perëndimit - një temë që rezonon shumë në Serbi - që përmban, për shembull, raketën hipersonike Zirkon, e cila u paraqit si një armë superiore që shkaktoi panik në Perëndim".

Shfrytëzimi i aktivitetëve bilaterale

Rusia gjithashtu ka shfrytëzuar potencialin propagandistik të aktivitetëve bilaterale me vëllezërit e saj sllavë, si për të dërguar mesazhe në Perëndim ashtu edhe për të fituar zemrat dhe mendjet e popullatës lokale. Për shembull, veprimtaritë ushtarake bilaterale të Rusisë me Serbinë, (vend i cili kërkon të ruajë neutralitetin e saj ushtarak dhe të bashkëpunojë me anëtarët e NATO-s dhe Rusinë), u përdorën për të gjeneruar narrativa në lidhje me rolin mbrojtës të Rusisë ndaj Serbisë. Rusia zgjeroi një marrëveshje dypalëshe për dhurimin e gjashtë MiG-29 për të mbushur boshllëkun në burimet e Serbisë për policinë ajrore,

duke siguruar pajisje që Beogradi nuk i kërkoi. Kështu, 30 tanke T-72 dhe 30 automjete BRDM-2 u përfshinë në marrëveshje. Tanket e para u dorëzuan në nëntor 2020, duke dërguar mesazhin se "nuk duhen më të mirë, duke pasur parasysh dobësitë e ushtrive të vendeve fqinje". Në stërvitjen dypalëshe anti-terroriste "Srem 2014" të mbajtur në fushat veriperëndimore të Serbisë, Rusia zgjeroi skenarin original duke shtuar pika parashutë të automjeteve të blinduara luftarake. Duke pasur parasysh afërsinë e Kroacisë, Hungarisë dhe Rumanisë, kjo dërgoi një mesazh në lidhje me aftësinë për të vepruar në thellësinë e territorit të NATO-s. Në një mënyrë të ngjashme, në stërvitjen "Slavic Shield" në 2019, sistemi S-400 u vendos përkohësisht në Serbi. Një fushatë e masmedias e mbushur me flamuj rusë shumë të spikatur dhe të dukshëm ushqyen spekulime se Rusia mund të ketë lënë

sistemin e raketave në vendin pritës. Stërvitja e planifikuar e këtij viti "Vëllezëria Sllave" anti-terroriste me Bjellorusinë dhe Serbinë në Brest do të kishte paraqitur një mundësi të re për Rusinë për të shtuar këto narrativa. Por Beogradi anuloi pjesëmarrjen në stërvitje, e cila, në një skenar të ndryshuar simuloi konfliktin me forcat e NATO-s përgjatë kufirit me Poloninë.

Lavdërimi i së kaluarës

"Aktivitetet në hapësirën e informacionit përqendrohen gjithashtu në kulturën e kujtesës, duke amplifikuar narrativat rreth viktimave historike dhe duke glorifikuar rolin e Bashkimit Sovjetik. Në vitin 2017, Sputnik Serbia filloi ndërtimin e një monumenti për viktimat e sulmeve ajrore të NATO-s në 1999. Në maj 2019, marshimi i "Regjimentit të Pavdekshëm" të Rusisë (ata që morën pjesë në "Luftën e Madhe Patriotike") u festua në Beograd. Të ndikuar nga Moskua, ky përkujtim përmbante ikonografi dhe rrëfim që

devijojnë nga tradita e festimit të veteranëve Jugosllavë të Luftës së Dytë Botërore. Interesante, veteranët e luftës së vitit 1999, të cilët nuk kishin marrë pjesë kurrë më parë, gjithashtu morën pjesë në këtë ngjarje.”

E ardhme e pasigurt?

“Fatkeqësisht, vendet e Ballkanit Perëndimor të Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë ka të ngjarë të vazhdojnë të jenë tokë pjellore për dezinformimin e huaj për të ardhmen e parashikueshme për shkak të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm”. Politika e jashtme e Serbisë bazohet në “katër shtyllat”, ([https://www.europarl.europa.eu/cmsdata/133504/Bashkëpunimi_i_Serbisë_me_Kinë, BE, Rusinë dhe ShBA.pdf](https://www.europarl.europa.eu/cmsdata/133504/Bashkëpunimi_i_Serbisë_me_Kinë,_BE,_Rusinë_dhe_ShBA.pdf)), për krijimin e marrëdhënieve të ekuilibruara me Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara, Rusinë dhe Kinën. Megjithëse anëtarësimi në BE mbetet një qëllim strategjik, vëmendje e veçantë i kushtohet nxitjes së marrëdhënieve me Moskën dhe Pekinin, të cilat nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ndryshe nga shumica e anëtarëve të BE-së dhe NATO-s. Kjo krijon një mjedis për veprim të shtuar nga aktorët e huaj në hapësirën mediatike. Në të njëjtën kohë, Republika Srpska ndjek politikën e Beogradit të neutralitetit ushtarak, për shembull, duke mos aspiruar të anëtarësohet në NATO dhe duke ndërtuar marrëdhënie me Rusinë. Ky pozicionim politik dhe çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës vazhdojnë të ngadalësojnë integrimin e Serbisë në BE dhe perspektivat e anëtarësimit në NATO të Bosnje dhe Hercegovinës. “Kjo i lejon Moskës të vazhdojë të paraqitet si mbrojtëse e interesave serbe. Përmes promovimit të vazhdueshëm të rrëfimeve të zgjedhura, Kremlini do të vazhdojë të forcojë ndikimin e tij në rajon. Për më tepër, ka të ngjarë që mund të duhen vite apo edhe dekada për të zgjidhur problemet ekzistuese në peizazhin mediatik të Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë dhe vendeve të tjera të rajonit, siç tregohet në një raport nga Parlamenti Evropian. Këto përfshijnë zbatimin e dobët të ligjeve ekzistuese, klientelizmin, politizimin, korrupsionin, fushatat e shpifjeve, krimet e urrejtjes dhe shpifjen, privatizimin e gabuar dhe çështjet e pronësisë së mediave (raporti i Clingendael “Ulja e lirisë së medias dhe raportimi i njëanshëm për aktorët e huaj në Serbi”, korrik 2020)”. Çështja është e komplikuar më tej nga vetë natyra e mediave online në rajon. “Kjo ilustron mirë me rastin e Serbisë, ku ka mbi 2,000 media të regjistruara. Kjo çon në mangësi, përfshirë vlerën e pamjaftueshme të tregut të medias;

Dhomat e lajmeve me pak personel që tentojnë të riciklojnë materiale nga media të tjera në vend që të ofrojnë raportime origjinale; gazetari me cilësi të ulët dhe mungesë ekspertize për të zbuluar dezinformimin, veçanërisht lidhur me tema të specializuara. Duke pasur parasysh këtë mjedis sfidues, një realitet paralel i përcaktuar nga narrativat propagandistike do të vazhdojë të formësojë hapësirën e informacionit të rajonit. Më shumë histori që shfaqin një fuqi të plotfuqishme që siguron udhëheqje dhe mbrojtje të patheksueshme, ndërsa prodhojnë mrekulli mjekësore dhe armë të fuqishme, nuk kanë ardhur ende”.

“Asnjë plumb argjendi”

Siç tregon shembulli serb, nuk ka asnjë plumb argjendi për të zbutur efektet e dezinformimit në Ballkanin Perëndimor. “Zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në praktika nga pjesë të tjera të Evropës nuk është i mjaftueshëm, nevojitet një qasje më e gjerë, inovative me mbështetje dhe koordinim ndërkombëtar. Rajonit i mungon infrastruktura e nevojshme për të luftuar dezinformimin. Kjo është një rezultat i mjediseve të qenësishme të dobëta institucionale dhe qëndrimeve pozitive të shumë njerëzve ndaj Rusisë, veprimtaritë e informacionit të së cilës nuk shihen si një kërcënim. Prandaj iniciativat e drejtuara nga shteti për të rritur ndërgjegjësimin dhe qëndrueshmërinë e qytetarëve përmes arsimit (të tilla si në Finlandë për shembull) janë vetëm në fazat e porsaardhura në rajon dhe merren me edukimin e përgjithshëm të mediave dhe reformat e medias, jo specifikisht me dezinformimin. Nën kujdesin e Ministrisë Serbe të Kulturës dhe Bashkimit Evropian, seminari i parë për shkrim-leximin mediatik u mbajt në nëntor 2020 në një shkollë fillore të Beogradit. Një seri për edukimin e fëmijëve mbi këtë temë u lansua gjithashtu në shërbimin publik kombëtar të TV. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, organizatat ndërkombëtare dhe sektori civil janë aktivë me projekte trajnuese për shkrim-leximin mediatik dhe kundërveprimtari të dezinformimit, por aktivitetet konsiderohen të fragmentuara dhe nuk kanë një qasje të koordinuar”. Në janar të vitit 2020, pas viteve të vonës, qeveria serbe miratoi një strategji të re mediatike për periudhën deri në 2025, me ndihmën e Bashkimit Evropian, Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, Norvegji dhe Stiftung Konrad Adenauer. “Ajo ka për qëllim të ndihmojë në zgjidhjen e disa prej problemeve afatgjata në sferën e medias, megjithëse ka mendime të

ndara në lidhje me perspektivat e zbatimit të tij.

Ndërkohë janë nisur në rajon disa portale të kontrollit të fakteve. Megjithëse një element i rëndësishëm në luftën kundër dezinformimit, kontrolli i fakteve është i natyrës reaguese dhe ka një audiencë të kufizuar. Për më tepër, kundërpeditë paraqiten ditë ose javë më vonë dhe nuk mund të ecin me ritmin e përmbajtjes propagandistike të prodhuar në masë. Një qasje e ndryshimit të lojës do të ishte trainimi i gazetarëve për të zbuluar dezinformimin dhe për të zhvilluar ekspertizë në fusha të specializuara për të prodhuar përmbajtje cilësore të bazuar në fakte. Sidoqoftë, shumica e medieve që veprojnë aktualisht nuk kanë nevojë për një ekspertizë të tillë duke pasur parasysh një mjedis që nuk do të shpërblejë përpjekje të tilla. Redaksitë e lajmeve me pak personel dhe më pak të paguar përqendrohen në sasinë e përmbajtjes sesa në cilësinë. Si rezultat, gazetarët shpesh ndryshojnë redaksi, largohen nga profesioni ose kalojnë në sektorin e komunikimit të korporatave më fitimprurëse. Kjo kryesisht i bën të pakuptimta efektet e dëshiruara të trajnimit. Për ta ndryshuar këtë, nevojiten platforma mediatike që lejojnë gazetarët lokalë të punojnë me kapacitet të plotë, të zbatojnë ekspertizën dhe të prodhojnë përmbajtje të bazuar në fakte paraprakisht, para se të ndodhë dezinformimi. Platforma të tilla mund të ndërtohen përmes koalicioneve lokale, rajonale ose më të gjera të raportimit të bazuar në fakte, duke u mbështetur në njohuritë gazetareske, ekspertizën, zbatimin e standardeve të larta etike, burimet e verifikueshme dhe trajnimin në vendin e punës”. Një iniciativë e tillë bazë është “Rrjeti Ballkanik i Sigurisë, i cili fuqizon gazetarët dhe redaktorët rajonalë me ekspertizë të mbrojtjes dhe sigurisë, e cila mungon në mediat lokale dhe rajonale. Lajmet dhe bazat e analizave të lajmeve të bazuara në fakte të BSN ribotohen nga një larmi mediash në të gjithë rajonin, nga javoret, të përditshmet dhe agjencitë e lajmeve deri te tabloidet me qarkullim të lartë, pavarësisht nga politika editoriale dhe orientimi. Kombinuar me iniciativat për verifikimin e fakteve dhe edukimin për media, kjo lloj platforme mediatike eksperte mund të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e numrit dhe cilësisë së narrativave të bazuara në fakte në rajon. Përpjekjet e koordinuara proaktive janë thelbësore dhe të zbatueshme përtej rajonit të Ballkanit për të adresuar çështjet universale të të gjitha shoqërive demokratike ndaj mesazheve të thjeshta të dezinformimit, populizmit dhe ekstremizmit”.

“Skënderbeu në historiografinë zvicerane”

Zbulohen shkrimet e para që flasin për Skënderbeun

Studiuesi i historisë Mr.sc.Murat Ajvazi kërkimet e tij në arkivat zvicerane mbi këndvështrimet e historiografisë së tyre për Skënderbeun i ka përfshirë në librin e tij të botuar më parë, me titull: “Skënderbeu në historiografinë zvicerane”.

Në një intervistë për “RTV AlbSe” historiani Murat Ajvazi i cili prej vitesh jeton në Zvicër tregon se si arriti ti sigurojë dokumentet zvicerane, që flasin për kohën e Skënderbeut. “Pas shumë kërkimeve kam arritur në Basel të gjej shkrimet e para, që flasin për Skënderbeun në vitin 1564 nga autori zviceran Paulo Spirios, një vepër e shkruar në gjermanishten e vjetër, gjuhën gotike, dhe arrita ti përmbledh të gjitha dokumentet në një studim me titull Skënderbeu, që është vetë hapi i parë dhe shpresoj, që gjeneratat e reja do të hulumtojnë më shumë. Në shekullin e XV ka shumë dokumente, ndaj duhet të shkojnë studiuesit e rinj t’i kërkojnë.”

Shkrimet zvicerane në gjuhën gjermane dhe frënge, këto shkrime janë të vërteta dhe të sakta dhe jo njëanëse, të gjitha këto shkrime i hedhin poshtë pretendimet se Skënderbeu ka qenë me origjinë sllave, i hedhin poshtë pretendimet se ka qenë pjesë e Osmanëve dhe nuk ka arritur të marrë pjesë në kryqëzata. Unë jam i lumtur që arrita të gjej këto dokumente, që e paraqesin Skënderbeun trim dhe arbëror, si një person që ka kontribuar nga largimi i Osmanëve në Ballkan. Kanë shkruar dhe për Lidhjen e Lezhës, të cilën e paraqesin si një Kuvend, që i bashkoi princat shqiptarë për të luftuar ndaj rrezikut otoman. Si Kuvendi i parë, që arriti të bashkojë princat pa ndihmën e askujt.

Gjithashtu historiani Ajvazi rrëfen edhe studimet e shumta në përkrahje të pavarësisë së Shqipërisë që ka arritur të gjejë në Kroaci.

“Gjatë kohës së studimeve qëndrova katër vite në Zagreb dhe arrita të gjej shumë dokumente, interesante është se shteti kroat ka pasur qëndrim të drejtë dhe gjithmonë ka dalë në krah të ushtrisë shqiptare, gjatë luftës së perandorisë Osmane ka pasur një përkrahje të madhe nga shteti kroat. Kam gjetur 20 gazeta kroate që kanë shkruar për çështjen shqiptare, luftën për pavarësi të Shqipërisë në faqet e para shkruanin se populli shqiptarë ka të drejtë dhe duhet ta shpallë pavarësinë. Në gazeta janë postuar dhe shumë shkrime për kontributin e shqiptarëve në çlirimin e Kroacisë.”

Veç përshkrimit të ngjarjeve, luftërave, betejave që bëri Skënderbeu, historianët në fjalë sjellin dhe fakte për indiferencën e shteteve të perëndimit ndaj rezistencës heroike të arbërve ndaj pushtuesit otoman (Vatikanit, Republikës së Venedikut, Austro-Hungarisë, etj), por edhe nga jeta shumë private e heroit tonë.(pengmarrja, kontaktet me të huajt, tradhtitë që u bënë, përpjekjet për likuidimin e tij, pastaj sjelljet e kalit të tij pas vdekjes së pronarit, etj.).Autori thekson

se ky nuk do të jetë studimi i fundit që ai bëri për të vërtetën për Kryeheroin tonë, Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Do të vazhdojë edhe hulumtimin e arkivave të shteteve tjera, si atyre gjermane, kroate, austriake, frënge etj.

Pas krijimit të Lidhjes së Historianëve Shqiptar profesor Ajvazi shpreson, që të organizojnë konferenca shkencore për figura të ndryshme historike shqiptare.

“Nuk kemi arritur të bëjmë konferencë shkencore, por pas krijimit të lidhjes shpresojmë të bëjmë konferenca shkencore për Aleksandër Moisiun, Nënë Terezën, Skënderbeun dhe presim të marrin pjesë edhe të huajt, jo vetëm shqiptarët. Mendoj, që në të ardhmen të gjitha shkollat shqipe në Zvicër një, ose 2 orë t’ia kushtojnë vizitës së përmendores së artistit të madh shqiptar Aleksandër Moisiu. Jam krenar që shqiptarët dhanë një emër që është Aleksandër Moisiu dhe me gjithë dëshirë, sepse Lugano, vendi ku është varri i Moisiut është vend shumë i njohur për turistët”, - tha historiani.

Por kjo nuk u ndal këtu, pasi një grup përkthyesish të zotë po punojnë për ta paraqitur këtë vepër të mirëfilltë historike edhe në gjuhën greke.Sëshpejti do të mundësohet botimi i tij në gjuhën greke nga Lidhja e Historianëve Shqiptarë, me seli në Zvicër.

Ja një pjesë nga përkthimi në greqisht i “Skënderbeu në Historiografinë Zvicerane”

“Në veprat dhe shkrimet e historianëve zviceranë, të cilët ndër vite hulumtova mirë në arkivat, bibliotekat dhe institucionet zvicerane, më shtynë të studioj këto shkrime, të cilat kanë nxjerrë në pah historinë e popullit shqiptar në shekullin XV, lufta e heroit tonë Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe pushtimi osman. Këta historianë dhe veçanërisht autorët Jean CharlesLeonard, Simonde de Sismondi dhe Ernest Münch, me qartësi dhe kujdes të madh në studimet e tyre, shpjegojnë historinë e sundimit të Perandorisë Osmane dhe betejat e zhvilluara nga Skënderbeu. Ata përshkruajnë qëllimin e pushtimit të Perandorisë Osmane, betejat e Skënderbeut me ushtrinë turke, vdekjen e Skënderbeut dhe ngjarjet që ndodhin në Ballkan dhe Evropë pas vdekjes së tij. Prandaj, gjatë gjithë studimit tim thelbësor të këtyre punimeve, jam përpjekur të hedh dritë mbi studimin e historianëve zviceranë nga heroi ynë kombëtar Skënderbeu, i cili është edhe thelbi i kësaj vepre “Skënderbeu në Historiografinë Zvicerane”. Sidoqoftë, kjo vepër ka të bëjë me 550 vjetorin e vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, fakt që karakterizohet nga shumë ngjarje shkencore dhe takime kushtuar kësaj periudhe kundër pushtimit osman. Shumë prezantime dhe kumtesa u prezantuan në këto takime shkencore të mbajtura në Lezhë dhe shumë vende të tjera të cilat hedhin dritë mbi një numër botimesh të ndryshme për Skënderbeun nga këndvështrimi i shumë njerëzve”.

RETROSPEKTIVË

Tanket në stërvitjen “Tomori ‘68”

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Detyra për marshim luftarak

Myfit Metanit nuk i hiqet nga mendja dhe sot në pleqëri marshimi i tankeve në stërvitjen “Tomori ‘68”. Ai kujton sakrificat e përkushtimin për detyrën, pa marrë parasysh vështirësitë deri dhe në dhënien e jetës. Pjesëmarrja në stërvitje të mëdha që zhvilloheshin shpesh në njësitë e repartet tankiste ishin shkollë e vërtetë.

Më 5 shkurt 1968 në zonën Korçë, Kolonjë, Pogradec, Përmet, Skrapar, Berat, Gramsh u zhvillua stërvitja e madhe me trupa “Tomori-‘68”. Pjesëmarrëse ishte edhe BrT në Poshnje të Beratit e formuar mbi bazën e batalionit të tankeve në Uznovë të Beratit.

BrT e Poshnjes në Berat ishte Rezervë e Komandës së Përgjithshme dhe mori pjesë me një kompani tankesh. 10 tanket në organik, ku bënë pjesë tri toga tankesh me nga tri tanke secila, dhe një tank komandanti i kompanisë. Kompania e BrT-së të Poshnjes së Beratit ishte e kompletuar me kuadro dhe efektivë të përgatitur. Nga shefi i shtabit të BrT-së Faik Pajo, kompania mori detyrë të kryente marshim në rrugëkalimin: Poshnje, Gurii Bardhë, gjatë rrjedhës së lumit Osum, Uji i Zi, Poliçan, Çorovodë, Hambull, Frashër i Përmetit e të përqendrohej te mali i Qelqit me gjatësi rreth 100 km për të marrë detyrën luftarake në kuadër të stërvitjes “Tomori-‘68”.

Marshimi ishte i vështirë, i pa praktikuar ndonjë herë me tanke në vendin tonë. Lëvizja u krye në një terren të thyer e në rrugë që funksiononin vetëm në verë. Kjo ishte një detyrë e përafërt si në luftë dhe ndikoi në mënyrë të veçantë, terreni i thyer e malor, dimri i ashpër, me dëborë dhe rruga e lëvizjes me rrezikshmëri të lartë për aksidente.

Myfit Metani ishte komandanti i kompanisë tankiste që do të kryente marshimin për në vendin e stërvitjes, larg zonës së tij të luftimit. Ai fillimisht kishte kryer detyrën e komandantit të togës dhe pas dy vitesh u emërua komandant kompanie.

Pjesëmarrja e tij në stërvitje të mëdha për së dyti herë, pas stërvitjes në Ardenicë të Lushnjes në tetor 1967, i dha atij përvojë, por edhe kishte përfituar nga eksperiencia e komandantit të mirënjohur Loni Kristo. Mësimet e vyera, kujton ish tankisti, na ishin ngulitur nga komandant Loni. Kjo stërvitje u bë për Myfit Metanin, pikënisje në përvetësimin e artit të përdorimit të tankeve në llojet e luftimit.

Lëvizja e tankeve për të arritur në detyrë

Kjo lëvizje e tankeve gati 100 km, ishte lëvizja e parë, që nuk ishte praktikuar më parë në historinë e armës së tankeve. Gjatë marshimit u ballafaquan



me vështirësi nga më të ndryshmet. Rruga nga Poshnja në Poliçan dhe Skrapar shkoi në përgjithësi mirë, sepse lëvizja u bë në rrugën automobilistike Berat-Skrapar, përgjatë rrjedhës së lumit Osum. Më tej në lëvizje kishte pengesa të pakalueshme për kalimin e tankeve.

Në vazhdim të lëvizjes kaluam me sukses urën e parë, ndërtuar në vitin 1947 me transversa hekuri në formë “T”-je. Ndërsa në urën e dytë, me mbërritjen e tankut të tretë në mes të urës, ajo shembet, tanku përmbysët dhe bie në përrua me kullën poshtë në tokë e zinxhirët nga sipër. U plagos tekniku Sotir Çobo, se qëndronte me gjysmën e trupit jashtë me kapakun e mbushësit të hapur. Teknikut ju dha ndihma e parë dhe u dërgua në spitalin e Poliçanit. Me ndërhyrje të menjëhershme u bë kthimi i tankut në pozicion normal dhe u rendit në vendin e vet të kolonës së marshimit. Ndërsa për tanket e tjerë, që nuk kishin kaluar urën, u ndërtua një anëkalim

nga ekuipazhet e tankeve, kaluan tanket nëpër anëkalim dhe me plotësimin e kolonës u rifillua lëvizja. Ekuipazhi me komandant tanku Stavri Bobon nuk pësoi dëmtime se ishin nëpër vendet e tyre brenda në tank. Nga ky pësim u morën masa dhe u urdhërua të mbyllën kapakët e ekuipazhit të tankeve. U bë një ndryshim në lëvizjen e kolonës së tankeve; koman-



Myfit Metani

danti i kompanisë me tankun e tij do të ishte në reshtim i parafundit për të ndihmuar tanket e tjerë në rast avarie gjatë marshimit. Në kalimin e urës pasardhëse, kur tanku i komandantit (i nënti) mbërriti në mes të urës, ajo u shemb menjëherë dhe tanku ra në përrua përmbys me kullë në tokë. Ura ishte e lartë dhe terreni për rreth saj ishte i vështirë për manovrim në nxjerrjen e tankut pa punime përgatitore.

Ekui pazhi i tankut ishim si të varur me kokë poshtë në tankun e përmbysur në përrua. Komandanti thirri me emër anëtarët e ekuipazhit dhe nëpërmjet zërit, ata ishin shëndosh e mirë. Shoferi i tankut Skënder Shahini nuk u përgjigj. Ai kish dalë nga tanku shëndosh e mirë, nëpërmjet vendit të lirë nga ana e tij. Ai shikonte si xhironin zinxhirët e tankut, se nga hutimi nuk e kishte fikur motorrin. U bë ndërhyrja e menjëhershme dhe komandanti i tankut Myfit Metani, shënjeshti Shpëtim Lamçe dhe mbushësi Nexhmi Braja dolën nga kapaku sekret, në dyshtim dhe tankut, prapa sediljes së shoferit. Efektivi që na priste jashtë tankut u gëzuan që dolëm pa dëmtime.

Pavarësisht se tanket ranë nga lartësi jo të vogla nga ura dhe u përmbysën në terrene tepër të vështirë, teknika dhe efektivi nuk pësuan asnjë avari ose dëmtime, sepse shërbeu teknika e re e tankeve të kohës. Astrit Çobani përfaqësuesi i komandës së tankeve e mjeteve të blinduara në MM, ndërhyri për eliminimin e menjëhershëm të avarive të lindura në marshim.

Vështirësi të tjera ndeshëm në rrugën Çorovodë-Hambull-Frashër-mali i Qelqit. Shumë pjesë të rrugës me kthesa të vështira e pa mbarim, njëra pas tjetrës, detyruan tankistët t'i zgjeronin e t'i përshtasin për të siguruar kalimin e tankeve. Në këtë rrugë të ngushtë kishte mjaft gremina që shkonin nga 1000-1500 m të thella. Por zbatimi rigoroz i masave të sigurimit teknik bëri, që të kalonim me sukses edhe këto pjesë të rrugës së marshimit. Me kalimin e Frashërit të Përmetit, u shtua vështirësia nga dëborat, ku detyroheshim të pastronim dëborën mbi 40 cm trashësi. Mobilizimi dhe përkushtimi bënë të mundur mbërritjen në kohë në malin e Qelqit, për të marrë detyrën luftarake. Këtu morëm falenderim nga kryeministri i Shqipërisë Mehmet Shehu për kryerjen në kohë të marshimit.

Zhvillimi i stërvitjes "Tomori-'69"

U futën në situatën luftarake. Morën detyrën në kuadrin e përgjithshëm, të veprimeve, që do kryente kompania e tankeve gjatë stërvitjes "Tomori-'68". Me dhënien e sinjalit të kushtrimit për fillimin e stërvitjes në të gjithë zonën, mijëra forca rezerviste lanë punën, rrëmbyen armët e pajisjet dhe me shpejtësi u paraqitën në pozicionet e tyre luftarake. U paraqitën në detyrë dhe repartet rezerviste të zonës së Potonit të Skraparit e të Frashërit të Përmetit për 8 orë, nga 12 orë të parashikuara në planet luftarake.

Në malin e Qelqit kompania tankiste mori pjesë në përgatitjen me artileri të mësymjes me predha qitje reale nga kompleti luftarak i tankeve. Nëpërmjet fushëpamjes së teleskopit të qitjes dhe instrumentet e vrojtimit në tank, moria e predhave që dilnin nga grykat e topave të tankeve dhe e armëve të artilerisë e transformuan tokën ku ato binin. Nuk dukej më dëborë, por tokë me dhe, e gropa pa mbarim. Kështu rregulloret e taktikës e në artin ushtarak bëheshin realitet në fushën e vërtetë të luftës dhe në një terren konkret.

Në momentin e sulmit të vija e hapjes poshtë Qafës së Zezë, për të sulmuar armikun "imagjinar" në Qafën e Qarrit mbërrin Abas Fejzo, komandant i Tankeve e Mjeteve të Blinduara në MM. Ky komandant i paharruar, megjithëse s'ishte tankist, e ngriti armën e tankeve, e bëri nga degë të tankeve, në komandë të tankeve e mjeteve të blinduara në ushtrinë shqiptare. Në atë pe-

riudhë u krijuan BrT në Shkodër, Laç, Sauk, Vorë, Kavajë, Lushnje, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Elbasan dhe në Poshnje të Beratit etj., me tanke cilësor të kohës. Komandant Abazi na përshëndeti me shumë përzemërsi. Kjo ishte një nxitje më shumë para sulmit që po kryenim. Abaz Fejzo, komandantit të kompanisë tankiste Myfit Metanit, i saktësoi më së miri disa të veçanta të mësymjes për rimarrjen e Qafës së Qarrit.

Filloi mësymja, ku u bë një realizim i përsosur midis tankeve dhe këmbësorisë shoqëruese të tankut. Ishte një sulm harmonik i tankeve në bashkëveprim me këmbësorinë nën mbështetjen e zjarrit të artilerisë. Me vrull dhe shpejtësi u rimorëm majat dominuese të Qafës së Qarrit. Armiku "imagjinar" u rrethua në fushën e Korçës.

Në lartësinë më dominuese të Qafës së Qarrit, Myfit Metani u urdhërua të ndalojë tankun. Hysni Kapo hipën mbi tank, e shikon edhe në brendësi nëpërmjet kapakëve mbi kullën e tankut. Ishte teknika më e re e tankeve, me të cilën u pajis ushtria shqiptare në vitet 1965-1975.

Rrethimi, sulmi, ndarja pjesë-pjesë dhe asgjësimi përfundimtar i "armikut" të parashikuar në fushën e Korçës ishte një imagjinatë e vërtetë e stërvitjes "Tomori '68", stërvitje me pjesëmarrje të mëdha trupash dhe që u zhvillua sipas kërkesave të Artit Ushtarak Popullor.

Fillimi i sulmit në mbrëmje nën mbështetjen e zjarrit të artilerisë ishte shumë i fuqishëm, tymi e flaka, fishekët e predhat gjurmëlënëse bënë një ndriçim të paparë ndonjë herë në fushën e Korçës. "Armiku" i tmerruar, filloi shenjat e kapitullimit. Në disa sektorë u bë ndarja



pjesë-pjesë e tij. Në vijim të sulmit u krye ngushtimi i vazhdueshëm i unazës së rrethimit të tij. Sulmi i tankeve u bë i fuqishëm. Terreni lejoi depërtimin e menjëhershëm të tyre në thellësi të mbrojtjes së armikut. Atij ju prenë të gjitha përpjekjet nga tanket e armët e tjera për kundërveprim dhe u realizua asgjësimi përfundimtar i armikut të rrethuar.

Në këtë stërvitje u argumentua si do realizohej copëtimi, ndarja pjesë-pjesë sidomos e këmbësorisë nga tanket, rrethimi e asgjësimi përfundimtar i armikut pa i lënë kohë për të kundërvepruar. Në përfundim të stërvitjes Mehmet Shehu, falenderoi tankistët e Poshnjes në mënyrë të veçantë për guximin e vendosmërinë e treguar në marshim të vështirë e pa ngjarje, mbërritjen në kohë në detyrë e realizimin me sukses të stërvitjes.

Në realizimin në kohë e pa ngjarje të marshimit në stërvitjen "Tomori '68" ishin dhe shoferët e tankeve. Pengesat dhe vështirësitë në marshim e stërvitje sidomos në rrugën Çorovodë-Hambull-Frashër-Qafa e Dëllinjës-Shemtit-Qafa e Qarrit ishin të panumërta. Të 10 shoferët e talentuar Ramazan Tufa, Sofokli Beci, Shpëtim Lamçe, Skënder Shahini, Ramazan Çangu, Shëfqet Plaku, Izet Qypi, Muhamet Zhilla, Selaudin Bamlari, Jovan Vani, treguan mjeshtëri, guxim, vendosmëri e heroizëm dhe i kaluan rrugët e vështira për të realizuar detyrën luftarake. Konkretizimi i çdo veprimi ishte i lidhur ngushtësisht me mjeshtërinë e përdorimit të tankeve në marshime e në fushëbetejë. Mjeshtëria e guidimit dhe manovrimit të tankeve i krijon taktikës mundësinë për të realizuar idetë më të përparuara në fushën e luftës.



TRUPAT E EOD NË LETONI

Vlerësime nga aleatët për përkushtim dhe profesionalizëm

